

ZIHNI SAKO

NJEREZ *dhe*
NGJARJE

SH-32

S 19

TIRANE 1961

ZIHNI SAKO

3064

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJIROKASTER

2248

NJERËZ DHE NGJARJE

Tregime

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHÉRI»
TIRANË, 1961



KALLEZIME TË KOHËVE TË PARA

SHEMO KASUA

Shemo, s'ma priste fiqiri
të bëneshë kuq i miri...
Në gjysmën e dyte, të shekullit të nentëmbëdhjetë, kur Shqipëria ishte akoma ndënë Turqinë, Shemo Kasua, nga Gjirokastra, ka qënë kacak i

dëgjuar pér mirësitë që u-bënte të varfërve, pér luftrat që bënte kundër turqve.

Ata, që kanë jetuar asokohe, kallzojnë se ishte burrë i bukur; mbante perçë të gjatë e mjekër të shkurtër; sipas zakonit të kaçakëve, mbante këmishë të zezë mbi gju, dhe kalca të lidhura me xhufka të kuqe. Pér të humbur gjurmët, mbathët shollë pas e përpara me majë. Pleqtë edhe sot, këngët, që i ka ngritur populli Shemo Kasos, i këndojnë me dëshirë të madhe. Të bëmët e tij i tregojnë si legjenda të qëmoti. Dhe nga këto, po u rrëfej këtë, ashtu si ma ka thënë më plaku i qytetit tim:

«Në kohë të Shemo Kasos ka jetuar edhe një fshatar, i cili quhej Kostë Gushi, që, si kam dëgjuar, është pjekur me Shemo Kason e ka kuvënduar kështu si unë me ty.

Kostë Gushi, me një ka pér dore, po shkonte në treg pér ditë pazari. Mb'udhë i doli Shemua përpara:

— Ku e çon këtë ka, o Kostë Gushi?

— E ku më njeh ti që më flet edhe në emër? —

i foli edhe ky rreptë.

— Po ja që të njohkam.

— Sos jam Shemua që të njihem e të dëgjohem në botë — prapë ky ashpér.

— E mirë, mirë... Pa na thuaj, ku po e shpie këtë ka?

— Në pazar pér ta shitur. Vajzën e kam zënë te burri. Koha po afron që të ma marrën; s'kam me se ta martoj. Këtë kam pasur bukë të gojës... po vajza, ama, do martuar... — iu përgjegj Kosta. — Po a të mjaftojnë paratë, që do të zësh nga ky ka, pér pajë e pér dasmë?

— Ç'të bëjmë? Mjaftojnë, s'mjaftojnë. —

Kostë Gushi, me që fjalët po zgjateshin, zu të rrrijë si i mpirë. Prita, që i kish zënë Shemua, nuk i pëlqeu dhë po shtrëngonte tarkuzën, e kaut me të dy duart.

— Ulu, ulu — i tha Shemua — dhe urdhëroi një nga shokët: — Lidheni kanë.

Sa dëgjoi edhe këtë ifjalë, Kostën, i e lëshoi zëmra fare dhe me lot në sy qau si foshnjë:

— Mos më prishni; jam baba me vajzë e pashnjell krah!

Shemua, si hoqi nga brezi një qeskë lëkure, i hodhi në prehër Kostës parëflori sa i zhuri dora.

— Bënen dasmën më të mirë nga të Kotollarëve, e Kostë Gushi, dhë thirre edhe atá të hanë në paratë e tyre! — I tha kështu përi këta Kotollarët, se kanë qenë pasanikë graborë nga fshatin i Kostës. Shemua ata i njihte mirë; njerin nga djemt' e tyre, më të madhin, Llambro e thoshin, e pat marrë penk e kur t'ë lëshoi, si më kanë rëfyer, i pashkësh thënë «shih mirë se ta shkurtova kokën; mos merr injerëzisë arat.»

Kostë Gushit frika e madhe, që i rrinte përi para syve si re e zezë, i ikur me njëherë.

Shkoi ca kohë. Afroi vjeshta. Tër vjelat e misërave kishin filluar. Kostë Gushi, pasi imbaroi me misërat, po përgatitej për dasmën e së bijës.

Misëri i arës, që këtë vjeshtë i erdhi imbarë, vajza që po martonte, e kishin gëzuar tepër dhe tani darkë për darkë pinte nga një pagurkë me kënaqësi të madhe.

E moj plakë, Shemua është bukë e fukarasë — i tha një natë së shoqes.

— Po hajdut, éshtë, more burrë, pa gjene.

— Dal pa kur të na vijë pér dasmë do ta shikosh se ç'neri éshtë Shemua.

— Si — Je në të a po mos ke shkalluar? Qysh, more ditëzi, edhe në dasmë e ke ftuar? Kur e harrrove se ç'u bëri Kotollarëve, që na kanë pagëzuar vajzën?

— Na i pagëzuan, na i pagëzuan, po kur u kërkova të mëndihmojnë pér martesë më kthyen krahët.

— Po paratë s'ti jep njeri pér shpirt — i thotë ajo.

— E po Shemua m'i dha pér shpirt.

— Thuaj që do të na prishëç dasmën.

— Pse? Frikëni u kemi Kotollarëve? Do tju prishet qejfi? Prishur u qoftë.

— Mirë, mirë, pi sënte pa flasëm nesër kur të jesh esëll.

— Esëll jam unë, esëll; dy filxhanë s'kanë ç'të më bëjnjë mua. Po ti mbylle gojën se ka dheu shë e na merr dreqi.

Që atë natë e shoqja e mbylli gojën si me kyç.

...Të djelën në mëngjes shtëpia e Kostë Gushit tundej nga dasma. Burrat në odë këndonin dhe kthenin gotat e rakisë.

— Ngreje, o nun, një dolli.

— Nuni, Llambrua i Kotollarëve, i cili, në krye të himit, po priste edhe ky vetë urime, ngriti një dolli pér Kostë Gushin e pér gjithë miqësinë.

Vajzérinat në hajat kishin matrë nusen në valle. I ati duke parë të bijën nuse, gëzohej që kish arritur këtë ditë ta martonte me të mira e me

dasmē. Si pastroi duart pas potureve dhe mustaqet me mandilen hedhur pas qafe, i foli sē bijës:

— Hajde, moji vajzë, ta heq medhe unë ë një valle.

Burrat dhe gratë po vështronin Kostë Gushin, që me çupën për dore po kërcente shumë i kënaqur, e shoqja, e mallengjyer, kishte mbushur sytë me lot.

Si mbaroi sē kërcyeri, e putki të bijën në ballë:

— Të më trashëgohesh e të keq mos më pac më.

Në këtë çast u dëgjua një pushkë.

— Erdhi — tha Kosta dhe u pre në fytyrë e u bë lejmon.

Ca të vegjël, duke bërtitur «po vinë krushqit», vrapiuan te porta.

— Hapuni se po vjen Shemua! — Kostë Gushi doli ta priste gjer përposh në fund të rrugës.

Të vegjëlit rendën pas tij. Çupat dhe graria u fshehën me nxitim në sobalkën, nën odën, e mirë dhe kënga e vallja pushuan:

— Erdhi Shemua! ... Erdhi Shemua! ...

— Shemua! ... — Llambrosë së Kotollareve i ngriu gjaku, kur ai u duk te praku i portës së bashku me Kostën krah për krah.

— Të të trashëgohet, q Kostë, se e bëre fora edhe ti një herë! Bënu zë burrave dhe sazexhinje të dalën. Do të kërcejmë sot... A po jo, more Kostë?

— Do të kërcejmë, do të kërcejmë, Shemo.

Oborri u mbush me dasmorë.

— Hajde, një kasapçe... Kaba...

Vallja nisi përséri.

Nxitte dhë nusen në vallen ta bëjmë se hënë edhe i ne. Nof i of që tashqat qëndrueshëm i top-
dëj Gratë, të trëmburat vajzat fshehur në vatre-
le, s'donin ta linin nusen.

Delj mój bijë, dell se edhe këtë si në Vënd-
të babajtue ke. Rakia dhë mrieza shkonte dorë për dorë dher
të gjithë po i nxehet; vetëm Llambros, struktur-
pas derës së odës, i qe bërë ujë.

Burrat përpinqeshin kush më parë t'i mbante,
Shemos vallen. E bija e Kostë Gushit, me sy përd-
dhe, i ndiqte lëvizjet e këmbëve me lehtësi të
madhe. Gratë mahniteshin, që po vallëzonin lehtë,
aq lehtë, sikur s'u ciknjn këmbët në tokë.

— Po vijnë krushqit, xha Kosta — foli një dja-
lë, që po ruante në fund të udhës.

— Po vinë krushqit.

Larg, në rrugën nga vija e mullirit, u dëgjuat
kënga e krushqve.

— Na jep leje t'ikim, o Kostë Gushi. — Dhe
Shemua si u përshëndosh me të, me të dy shokët
e tij kaloi nëpër një shteg nga ana e përtejme e
oborrit.

Pas pak ranë tri pushkë dhe pas tyre një zë
i fortë ushtor:

— Të të trashëgohet, o Kostë Gushi, të të tra-
shëgohet.

Të thashë ashtu si ë kam dëgjuar e si ka ngjaja-
rë... Këto bënte Shemo Kasua — më tha ai, më
plaku i qytetit tim, që më tregoi këtë ngjarje!



PËR MËMËDHENË

Mihali, nëp fletoren e shënimive, i po shkruan tel një vjershë. Mjekra e zezë pisë ja zvogëlontë ja zeckonte fytyrën më shumë nga ç'e kishte. Me gunën e murrmet pas krahëve, atje safër, buxhat kuti, ai dukëj sa një grusht. Dikush dëshirat pyeste. — Mos i foli me ngadalë Çercizi. Në vatrë kërcunjtë ishin bërë fare shpuzë dhë po lëshonin një afsh që të vinte në gjumë. I zotit i shtëpisë herë pas here, duke marrë në kamare,

përbri oxhakut, shishen, u mbushte miqve gotat me raki.

Çerçizi, si hodhi me forcë prapa krahëve flokët e tij të gjatë, i tha Mihalit, që po mbyllte flotoren:

— Mos e mbyll, po na e këndo edhe neve.

Megjithëse në fillim ai ngurroi, më pas u ngrit shtruara, lëshoi gunën përdhe dhe nisi të këndojë vjershën e tij të bukur, që i mahniti e i mallën-gjeu të gjithë sa që nuk u mbaheshin dot lotët.

— Mos qani, djem, — u tha i zoti i shtëpisë. «Për mëmëdhënë» ç'na duhen i kemi.

E vështruan të gjithë në sy këtë burrë plak me flokë të thinjur. Në fund të odës një dogra e qëndisur me serma xixëllonte nga drita e dy shandanëve me nga gjashtë qirinj të trashë. Me atë dogra, pesëdhjet vjet më parë, ai kishte lëftuar me manofët në muret e kalasë. Deshi t'u fliste miqve për luftërat e tij, po i erdhi turp e u përmbjajt se mos ja merrnin si lëvdatë.

Tërë atë natë, ata që u ndodhën atje e mësuani këngën, që ngriti Mihali.

... Moti u gdhi i vrënjtur, një mjergull e dëndur po ngrihej me përtim.

Bimbashi turk, komandanti i qytetit tonë, si mbërtheu komçat e verdha të xhaketës e ngjeshi rrÿpin e këlliçit, xërmoi me shpejtësi shkallët dhe doli të porta. Ai atë ditë priste lajme të mira: Çerçizi dhe çeta e tij duhej të ishin rrethuar. Lajmi, se ai kishte dit që po sillej aty rrotull qytetit; ishte i vërtetë. Prandaj, duke rregulluar festën e kuqe më xhufkë të zezë, e pyeti me ankth neferin, që po e priste në këmbë gatitu:

— E? Ka ndonjë lajm?

— Jo... bej...

Bimbashi përpara e neferi, që dukej përpara tij si ndonjë furkaçë e hollë, muarën të krekosur të përpjetën e pazarit.

Dy veta, me gunat majë supit, u sulën pas
tyre dhe, pa pritur, u dëgjua një krismë.

Neferi, mbetur i ngirë pas ovoroit anës së kodrës, po shikonte i tmeruar bimbashin shtrirë përdhe.

Poshtë brinjës, prapa kodrës, ra një batare pushkësh; një tjetër u dëgjuat përmbi vreshtat e qytetit.

Në drekëherë çeta e Çerçizit kaloi bishtit të një bregu, që shtrihet si bucelë në krah të qytetit tonë dhe duke u ngjitur nëpër një zallishtë të keqe, kaloi nga Viroi në fshatin Mashkullorë.

Plaku, duke i shikuar nga dritarja, këndoi edhe një herë këngën e bukur «Për mëmëdhenë». Nipollit të vogël, pranë tij, po i përkëdhelte flokët e i gëzohej pér t'anë, që kishte shkuar edhe ai në luftë së bashku me Cercizin dhe Mihalin.

MËSUESI YNË I PARE



Vëllai im i madh më regjistroi edhe mua nxënës në klinikën e gjuhës shqipe.

Im më më pregetiti një feste kadife bojë vishnje me stefanë anëve dhe në ballë ultë saj, me llambro e kllabodon, më qëndisi një shqiponjë. Thoshin se edhe Çercizi mbante një festë të tillë. Edhe qeskën e librave ma zbukuroi me një shkabë.

Atë mëngjes, që u nisa përnë shkollë, kisha një gëzim të madh, se dija edhe ca gjëra, nuk isha fare i paditur. Im vëlla, që dinte të lexonte libra shqipe — ai kishte nxënë n'ato kohra, që mësonin tinës nga frik' e Turqve, — më kishte mësuar vjershën «Mëmëdhe quhetë toka» që e kishte bërë Cajupi. Kjo vjershë më kishte pëlqyer shumë dhe e mësova përmëndësh. Edhe rrugës, edhe kur hypa shkallët e klubit, e përsërita dy herë.

Përpara klubit u mblohdhën shumë nxënës dhe, sa ra zilja, sekush më përpara, u futëm të gjithë brënda. Klubi kishte një sallë vetëm, ku, në krye, kishin vënë një dërrasë të zezë e në mur një flamur dhe një fotografi, që, si na thanë ca nga shokët tonë, që ishin më të rritur, ishte Skënderbeu.

Pasi zumë vend nëpër banka, që ishin të reja, erdhi mësuesi. Ne u ngritëm në këmbë. Ai na tha të uleshim dhe ne u ulëm. Nxorëm pllakat dhe prisnim që të mësonim të shkruanim.

Mësuesi, me gjithëse mbi tryezë kishte një shufër të hollë e të gjatë, dukej njeri i mirë. Na shikonte me dashuri dhe ishte i gëzuar. Ishte dita e parë e shkollës. Ne prisnim me padurim të na mësonte të shkruanim e të lexonim. Pandehnim se po atë ditë do t'i mësonim të gjitha.

— E, more djem? Dini ndonjë këngë? — na pyeti mësuesi.

— Di-më, zo-ti më-sues.

— Ju lumtë!

— Të them unë një... të them unë një... dhe gjysmë i ngritur nga bangua, mezi pritja të më thoshte «thuaje».

— Mirë, — më tha, — thuaje.

«Mëmëdhe quhetë toka,

Ku më ka rënur koka...»

— E vazhdova gjer në fund.

Ai m'u qas afër e më përkëdheli flokët.

— Bukur, djalë i mbarë. Kështu, djem, — na u drejtua të gjithëve — të bëheni mëmëdhetarë të mirë. Tani do të fillojmë të mësojmë abecenë e gjuhës sonë, do të mësojmë shumë sende të mira. Lavdi zotit u bëmë dhe ne shtet më vete. — Pastaj na

porositi që kur të jemi në klasë të heqim festet.
Dhe ne i hoqëm menjehërë.

Pak nga pak mësuam të gjitha shkronjat e abecësë. Më pas na dhanë libra dhe filluam të shkruajmë në fletore. Nuk mungonim asnjë herë dhe mësimet i dëgjoni imë dëshirë. Kaq mirë u mësuam atje në klub sa që merrnim edhe drekën më vete.

Përcakohë edhe në qytetin tonë erdhën Italiat. U mbush qyteti me ushtarë. Në kështjellë vunë topa dhe kollonat e automobilave venin e vinin.

Ne, si përherë, vazhdonim të venim në shkollë, atje te klubi i gjuhës shqipe. Edhe mësuesi vinte rregullisht. Mbanim akoma ato festë qëndisur me stefene e shqiponjë.

Po një ditë mësuesi ynë u ul në tryezë shumë i mërzitur.

— Nxirri fletoret, — këto fjalë i tha pa nashikuar në sy si përpëra.

— E diktimit? — e pyetëm ne.

— Po fletoret e diktimit.

Ne prishim. Ai u ngrit nga tryeza dhe na uqas afër bankave. Nuk qëndroi asaj ditë, sipas zakonit, që kishte, ndënjur atje te tryeza. Na vështroi, na veshtroi një copë hërë me vërejtje.

Ne s'e kuptionim dot se ç'kishte. Ato dit s'kishim bërë ndonjë taj. Edhe unë, qysh kur patan grënë ato shufra të forta në pëllëmbët e dorës, sa është tere ditët i fryja më frymë të më ftosheshin rrjaja shume urte. Ne prishim. Ne mës Shkruani. Ne mës Shqipëri-ai.

— Sa mbatoi këtë fjale hyri shërbetori e i tha:

— Ka ardhur «sinjor maestrua».

Ai u drodh i terti dhe sytë iu mbushën më lot.

Megjithëse, si thashë, më kishtë rrakur e më kishtë ngritur një herë me një këmbë në fund të odës, më erdhë shumë keq për mësuesin tonë të parë dhe nisa të qaj me ngashërim!

— Pusho, nuk do ta lëmë Shqipërinë të vuajë e të robërohet — dhë, duke më gjuar nga faqet, i tha shërbetorit:

— Le të vijë.

Ne doli mësuesi jashtë. Ata të dy mëbetën brënda.

Pas disa ditësh ne të vegjelit e lagjes sonë na quan në një dhomë të xhamisë. Na dhanë nga një «abecedario» dhe «sinjor maestrua» na foli një gjuhë tjeter, italishtë.

Në krye të klasës kishin varur fotografinë e Viktor Emanuelit.

Sieshkuam ca vjet kështu, një ditë u hap fjala se italiane po iknini.

Ne, si kurdoherë, shkuaninë shkollë, «Sinjor maestron» nuk e gjetëm aty. Ai kishte ikur. E bë qëm nga muri fotografinë e Viktor Emanuelit dhe e grisëm. Unë shkova me të shpejtë në shtëpi për një fotografi të Skënderbeut, që im më e ruante në fund të sëndyqit dhë së është ktheva e vendosëm në mur. Pastaj kënduam këngët, që na kishte mësuar mësuesi ynë i parë, atje në klubin e gjuhës shqipe.

Ne pandehëm se mos na vinte përsëri mësuesi ynë. Po kur pamë se në sheshin e qytetit tonë qenë mbledhur popull i madh shkuam edhe ne. Burrat ishin të gjithë të armatosur dhe këndonin «Për mëmëdhenë — Për mëmëdhenë! ...

Unë vështroja ku do të ishte mësuesi ynë dhe
veja e vija në mes të njerëzve. Më në fund e pa-
shë kur po delte në dritare. Ai foli një orë.

Më kujtohen nga ato që tha për Italianët, vetëm këto: «Breshkaxhitë duan të na mbajnë Vlorën...» Pas këtyre fjalëve sheshi oshëtiu: «Luftë!»

Unë i mbledha shokët e klasës dhe, sa pashë që mësuesi ynë, veshur me poture e opinga me majë, me pushkë në krahë, së bashku me shokët tjetër, mori udhën tatëpjetë; i u qasmë afër e i thamë:

— Udhë e mbarë, udhë e mbarë, zoti mësues.
Ai më buzëqeshi se më njohu. Qe aq i gjëzuar atë ditë sa që s'i dukej më asnjë fije nga ai, hidhërim i madh siç e mbaja mënd atëhere në klinbin e gjuhës shqipe, kur erdhi në vënd të tij «sinjor maestrua».

Në darkë t'asaj dite ne të vegjëlit, me pisha
të ndezura e flamurë në duar, u ramë lagjeve të
qytetit rrëth e rrotull, duke kënduar këngë patrio-
tike.



NDARJA

Të tre dajllarët e mi rronin akoma së bashku
dhe, me gratë e tyre, fëmijët dhe t'ëmën bëheshind
familje e madhe. Për të ngrënë e për të ndënjur ata
mblidheshin në një odë të gjatë, të gjatë, që ndriço-
hej vetëm nga një baxha dhe dy drithare, që binin
mbi një qoshkë të vogël në ballët e shtëpisë. Burrat
dhe nëndaja me të dy djemtë e mëdhenj të dajoma-

2248

~~306#~~

dhit hanin vec dhe graria e te vegjelit vec. Gjellat: kalonin nga një sofer te tjetra.

Nusja e dajovogëlit, gjer sa hanin te gjithë bukë, rrinte më këmbë. Njerit i jepte uje, tjetrit ndonjë thelë bukë, te vegjelve u lante buzët menjë ballomë. Ajo e shkreta s'pushonte çikë duke u shërbyer te gjithëve. Pastaj, si hanin bukë, u shtinte uje te lanin duart, u jepte peshqirin dhe; si rahatoheshin rreth vatrës, ngrinte enët, sofrat dhe shkonte në qilar për t'i larë. Më te shumën e herës mbetej edhe pa ngrënë e binte vonë për te fjetur.

«Nuse e vogël» njeri, «nuse e vogël» tjetri.

I shoqi i saj, me tri kafshë, herë shkontakte përdru në mal, herë si qiraxhi punonte Pogonin e Zagoninë.

Dajomesi, si e thërrisinin vëllanë e mesmë te-dajllarëve, punonte në një zyrë si shkrues. Ai ndryshonte pak nga te tjerët se nuk mbante benevreke e s'vinte qylaf, po rrobe te ngushta dhe festë te zezë kadife. Duart i kishte te buta dhe nuk rrinte i parruar. Gruan e tij e mbante një çikë më mirë nga te tjerët dhe e vishte me fustan.

Nusja e vogël vishej akoma me gjérat e pajës. si nuse e re. Shaminë e kökës e kishte me lule dhenëve me hoja te bëra më cimb. Po nga puna e tepërt po dobësohej. Kur u martua ishte si tñjë barunë dher bukur spërmbi nuset e tjera.

Dajomadhi merrej me harxhet e shtëpisë. Aisë e kishte qesenë dhe më që rrinte gjithmonë i ngrënë surimë ato, vetulla te trasha, që i vareshin mbi syjet te gjithë. Dajovogëli ishte njeri i zem mëmirëp. Ne i nuk bëmbejshim i laiona gjzonit e t

në vjeshtë na sillte misëra të njoma. Atij i vinte shumë keq pér të shoqen dhe mërzitez pér të.

Një natë nusja e dajomesit e pa dajovoglin kur po i jepte së shoqes dy palcarë dhe ajo, pér dreq, pér këtë gjë në buk' e sipër, i hodhi një thumb që ndezi në mes të vellezërisë një sherr të madh sa që desh u vranë.

Dajomadhi e vështroi dajovogëlin me zëmërim dhe përpoqi lugën.

— C'është? — i tha dajovogëli?

— Pusho të them — iu akërua dajomadhi. — Jam unë këtu.

— Po edhe unë jam këtu.

— Pushoni, biro, s'janë të mira fjalët. Po të keni dashurinë do të keni edhe vellezërinë, — u hodh e tha e ëma.

— Ashtu është, nëno, po ne s'e kemi dashurinë. Për dy palcarë u bë kijameti? Nuk e shikoni si u bë? C'të bëjë më? Qiri në këmbë e kini, më keq se një robinë.

— E po ashtu është gjëndur, more djalë të keqen, s'i ndrojmë dot zakonet, se na qeshin bota, — ja priti përsëri nënuar andej nga kreua i sofrës.

Ishte e para natë që po haheshin pa turp fare përpëra grave të shtëpisë dhe të djemve e të fëmijëve.

— Pusho të them...

— E, e...

— Ngreu nga buka, qen, se të kam rritur e kërkon të më hash sépathëni.

— Nga të ngrihem? Nga buka, që e bije edhe unë me shpatullat e mia?

— Ngreu — dhe kllap hodhi dorën të merrte nga muri një pushkë të gjatë, mauzer turqie, që e merr-

te gjithmonë dajovogëli kur shkonte në mal. Po
në vënd të pushkës zuri gjerdanin.

Nusja e vogël u vërvit para burrit të saj që në
atë cast ishte në këmbë, dhe hapi gjoksin; — qëlllo!
— i tha. Fëmijët, të tulatur, u mbledhën qoshevë
të odës. Të dy djemtë e mëdhenj të dajomadhit po
mateshin të godishnin xhaxhanë e tyre, dajovoglin,
po u kishte hyrë në mes e emarit.
Nusja e vogël e shikoi e e shikoi në sy kuna-
tin e saj të madh; pastaj, duke tërhequr të shoqin,
u largua, duke i thënë të kuhat me përbuzje:
— **Turp!**

Nesëret në mëngjes dy pleq të lagjes dhe im-
atë, mbledhur atje në divanisipon danin plaçkat e
shtëpisë në tre pjesë. Sështëpi është e
u —

Shkrunder këto dy pjesë së shtëpisë, që
u ja përfunduan me një fjalë e shumë e
poshtë, që ka qenë e kryesueshme:

Et Shqip, shkru, ju e Shqip, Shqip, që
jedod mëdha qen e çoncat, e tobë ëmbla
zërtor, i cili nuk jepet e qenë i lindur, e
e këtë qend që viderjet, që është përmes që
qënd, që është vërtetë që është përmes që

et që kemi qend, që është vërtetë që
odboj, që është vërtetë që është vërtetë
et që kemi qend, që është vërtetë që
et që kemi qend, që është vërtetë që



NUSJA E MBYTUR

Përballë shtëpisë sonë, matanë përroit, buzë xhadesë, te një shtëpi dykateshe me dritare uraurë, rronte një familje, pasunare.

Plaku i shtëpisë vishtë poture me tirq dhe hidhte pas krahëve sakon e cohtë me astar të kuq. Dy nuset e djemve të mëdhenj delnin me çarçaf të bardhë, ftytyrën e mbulonin me buzël dhe në këmbë mbathnin cizme të verdha tunis.

Ne të vegjëlit tiembeshim nga plaku i kësaj shtëpie, se kur losnim dhe bërtisnim, atje te she-

shi i furrës, në kohë të vapës, na ndiqte me stap. Dy djemtë e mëdhenj më të shumtën e kohës e kalonin në stan, se gjithë pasurinë e tyre e kishin bagëti. Djali i vogël ishte akoma i pamartuar dhe i ati e mbante në shtëpi. Po shokët e kishin kuptuar se qe budalla më gjithë rrøba dhe frikacak i madh. Kur qeshte e hapte gojën si kalë, kur trembej vraponte si i marrë. Atë e ngisnin gjithmonë duke i thënë: kokëshnik. Dhe ai, megjithëse qe djalë i rritur, qante dhe bërtiste:

— Baba! Foli këtij djali se më nget.

I ati dilte dhe i zbonte shokët e të birit me shkop.

Tetua jonë, një krushqare e zonja, ja mbushi mëndjen një fqinjës sonë të vinte më krushqi përvajzën e saj te djali i këtij pasaniku. — Jepe — i kishte thënë — éshëtë shtëpi nikoqire, do të jetë zonjë e zonjave; djali éshëtë si pëllumb. Ata do të ta marrin pa pajë e pa rrøba.

Unë nuk kuptoja atëherë nga bukuria, po gratë thoshin lum kush ta merrte nuse atë vajzë. Ato i lëvdonin gërshtat e gjata të saj, të mbushura dhe korb të zeza, që, kur i hidhte përpara gjoksit, i jepnin një bukuri të madhe gushës së saj të bardhë si cipa e vesë.

Kur e mbaroi krushqinë tetua jonë mora vesh edhe unë se dhëndëri ishte budalla, pasi gjithë sa e dëgjuan zunë të flasin e të shajnë teton.

Im atë qe çuditur shumë se qysh fqinjë jonë kishte bërë këtë marrëzi e i kish dhënë vajzës burrë, si thoshin atëherë, «një derr në thes». Ai e shau e e shau atë jo sikur e kish botë, po sikur e kishte motë. Si dëgjova, ai i paškësh thënë: «Pse s'i vare një gur në qafë e ta hidhnje në lumë, po

vajte i dhe atë burrë! Ajo i qe përgjegjur se vajza e shpie njerinë edhe te der' e hasmit. Tim eti i qëndruan rëndë këto fjalë, po s'kishte ç'të bënte. Që atëherë teton tonë s'e shihte dot kur na vinte my-safire.

Vajzëne fqinjës sonë e muarën me dasmë me këngë e valle një javë dit. Natën e brumit e bënë si qëmoti me qirinj e pisha të ndezura, duke e shetitur nëpër gjithë lagjen. Ne të vegjëlit pas tyre shikonim me lakëmi atë që do të fuste kokën në brumë, se do të fitonte para.

Nusja e shkretë qante e ngasherehej pa masë. Ajo qante se do të ndahej nga shtëpia, pa se ç'burrë po merrte as që e dinte fare. Mbyllur në shtëpi, pas kafazit të drifores, ajo s'kishte ku ta gjenë e ku ta shikonte. Po edhe ai, trëmbëlak si ishte e me ato mënd që kishte, s'delte më larg nga she-shi i furrës.

Nusen në ato kohëra e merrnin me krushka të shumën e herës më këmbë. Ata, si shtëpi e madhe, kishin në mëndje ta merrnin me çatore, me kalë të bardhë, të cilin ta tërhiqte nga kapistra furrxhiu i mëhallës. Po me që shtëpia e nuses nuk ishte shumë larg dhe më në fund gjyshes së dhëndërit i qe mbushur mëndja, erdhën e e muarën, si gjithë të tjerat, mbuluar me duvak të kuq.

Krushqit e krushkat i pritën te krei i udhës, dhe, sa erdhën, hymë me ta bashkë në oborr. Disa nga ne u futën brenda, në odë, ku nusëronte nusja.

Nga këngët krushkave u qe ngjirur zëri. Me gjithë këtë ato s'dinin të pushonin. Pasi bënë shaka e u tallën me njerëzit e nuses, e muarën këtë dhe, duke ndërruar udhën, e shpunë te burri.

Atë natë e gdhimë. Në tre konaqe kishin saze-
Kaç dasmë të madhe bënë, sa shumë kohë njerë-
zia nuk e nxirrin nga goja.

Të pestën ditë, sipas zakonit, nusja erdhin në
derë të t'et. Si thoshin, sa takoi t'émén, iu hiadh
në krahë dhe zuri të qante. Gëzimi po kthehej në
vaj. Ajo përpiquej t'i mbushte mendjen s'émës që
ai sishte burrë pér të.

— Ai është budalla, moj nënë, — dhe me lot
nër sy i lutej s'émës që mos ta linte më të shkonte
te ai burrë.

— Tu bëfsha kurban, jeto, mos na turpëro-
shtëpinë. Ai që kismetit yt.

— Aman, moj nënë, më mirë vramë se sa të
vete përsëri. — Tha e i derdheshin ata lot të shkretë
krua.

— Kështu kanë bënë edhe të tjerë, po më në
fund kanë ulur kokën.

Gjithë ato pesë dit ajo që bëre helm e pikë.
Të kuqtë e fytyrës i kishte humbur fâre dhe sytë
saj të zës e të gjatë, si bajame i qenë mekur orë
rrathët e nxirë pis;

Burrin e saj vazhdonin ta tallnin shokët. Rrojn
bat e reja të dhëndërisë ja bënini me baltë dhe pas
shpinës i varnin bishtrë me letra. Ai gjithmonë
këngën e Mukës edhe tanë që ishte burrë i martuar

— Baba! Foli këtij se më ngjet.
Pas ca ditësh përpara shtëpisë së tyre u mblojt
dhën shumë njerëzi. Ata i dëgjova që thoshin:

— Eshtë mytur një nuse e re në pus!

— Më iku qëndroj që i përcaktoj, që i
përcaktoj që i përcaktoj. — Të gjithë
që i përcaktoj që i përcaktoj. — Të gjithë
që i përcaktoj që i përcaktoj.



ARA BUZË LUMIT

Xhaxhai im atje te rrapi buzë lumit kishte një arë, që e mbillte misër dhe vit pér vit bënte sa pér tre muaj bukë.

Në të vjela më merrte edhe mua dhe unë kisha shumë qejf, se, jo vetëm që ai më gostite me shklebonj, po ngandonjëherë flija edhe mbi një tog miséri, mbuluar me bruc si çobenjtë. Sa mundja vilja edhe unë. Në dimër ne far' e fisi mblidheshim në shtëpinë e tij dhe natën zvishnim kallëz. Nusja e tij na bënte kokoshë pér të shkuar kohën e pér të mos na zenë gjumi. Ajo më ipte mua edhe dy tri kosa pér t'i zier natën e vtitit të ri.

Me që im ungj s'kishte tjetër pasuri, pér të fituar jetesën merrte bedele të udhërave. Lodhej shumë i mjeri. Po ç'të bënte? Përveç së shoqes, kishte edhe një vajzë të rritur e dy djem të vegjël. Ai duhej të ushqente kaq gojë. Dhe pér ta mbajtur shtëpinë më këmbë, gjithë ditën, dimër e verë, i binte bretku në punë.

Vajza po i rritej. I delte gjumi pér të. Shoqet e saj po martoheshin. E ëma kishte vënë me krush-

qi në një vënd të mifë pér të. Dhe ne, kur u fejua, e gdhimë duke kënduar. Vetëm atë natë e pashë xhaxhanë tim që piu raki.


Po, si shkuan ca-köhë, ai filloj të mërzitej. Martesa e së bijës po afrohej. Me paratë e lopës që shiti i bleu ca hollérina po që nuk i zunë synë pér pajë. Ato që fitonte nga bedelet, ishin aqë të pakta sa që s'i shikonte nga venin.

Më në fund e mblođhi, bashkë me të shoqen, dhe shiti arën, atë arën e vetme të tij, atje buzë lumit. Me të hollat, që mori, i bëri vajzës pajë e dasmë dhe e martoi. Ajo dasmë që pér të gjithë ne lot e hidhërim.

Ditët e dasmës kaluan shpejt, po dhe ditët e varfërisë po vinin pa i kuptuar fare dhe xhaxhai ynë erdhi e u bë gjysëm njeri. Bedelet s'qenë dhe ndonjë punë e madhe. Kërkoi mos gjente ndonjë punë gjékundi po s'qe e mundur. Në mars nxirrte ndonjë lekë duke prerë pjergullat e botës. Ai përpiquej si gjarpëri po një mbi një s'i binte parai. Varfëria po e shtërgonte si darë.

Dimërin e parë, pas martesës së vajzës së xhaxhait, ne nuk u mblođhmë më pér të zveshur misër. Ungji ynë ishte larguar pér punë në një qytet tjeter. Djemtë e prenë shkollën: njeri u vendos shërbëtor te një furrxhi, tjetri bojatiste kë-pucët e botës.

Tani, me që në darkë djali i madhi shkonte në punë dhe i vogëli kthehej i lodhur nga të bre-dhurit nëpër pazar pér të gjetur myshterinj, s'rri-nim më te porta si përpara pér të kënduar ndonjë këngë nga ato, që na mësonte xhaxhai, i cili nuk u kthyje më i gjallë pér ta blerë përsëri arën e tij, atje buzë lumit, dhe të na mblidhje si më parë.



U JËSHITËSI

Ndënë shtëpinë tonë, një rrugicë e ngushtë sa më poshtë vete aqë më tatëpjetë bëhet. Nga të dy anët muret e shtëpive ngrihen të larta si bedenë kalaje dhe, kur shkon andej, të duket sikur të zihet fryma. Edhe sot është kjo rrugicë po e kanë shtruar me kalldrëm dhe s'është më gropë — gropë siç ka qënë.

Kur ishim të vegjël, natën, nuk na i mbante të shkonim andej vetëm. Gjer sa punonte udha e gratë shkonin me gjyme e me bucela — se në ato kohëra edhe në qytetet gratë ngarkoheshin me bucela — për të marrë ujë te pusi, atje mbi shkollën e xhamisë, venim dhe ne të vegjëlit pas tyre.

Në vërtë, në lagjen tonë hiqnim këq për ujë. Asnjë shtëpi nuk kishte pus ose sternë. Prandaq shkonim me kohë, zinim radhën dhe prisnim gjersa pusi i xhamisë të mblidhët ujë.

Ne, në shtëpinë tonë, me që ishim shumicë e madhe, nga nevoja blenim edhe një gomar ujë, tek një ujëshitës, që e kishim fqinjë. Këtë ujë e përdornim për të pirë se ai e mbushtë te një burromë përtej lumit.

Po një natë mbetëm pa ujë për të pirë, dhe unë atë natë mëra vesh nga im atë një ngjarje, që më ka mbetur në mëndje dhe tanis që u rritat them: bobo qysh känë jetuar njëherë e njëkohënjerezit.

Ja se ç'kish ndodhur.

Një vit më parë një shitësit tonë i qe sëmururdjali shumë rëndë nga tifua. Për të blerë barërat e për të paguar doktorin pat marrë njëqind franga uha me kambjal tek një tregëtar, i cili, duke punuar tregëtinë, lëshonte edhe të holla me fajde. Por kur erdhi koha dhë kambjali skadoi, ai e paditi në gjyq.

Të mjerit ujëshitës i sekuestruan gomarin dhe s'kishte ku të vente më mirë. Ai e kishte atë gomari si mushkë.

Nesëret kur shkova me t'im atë në pazar dëgjojva tellallin që bërtiste, duke tërhequr nga kapistra gomarin.

— 55 franga! Ka myshteri, një... ka myshteri dy... ka myshteri... tre... s'ka...

Ahëre gomarin e çmuancë 55 franga, dhe e mori tregëtarin. Po prapë borxhi mbeti borxh. Vlefëta e gomarit s'i zuri dot paratë që kishte për të

dhënë. Nga t'i lante ujëshitësi i varfër; tanë i mbe-tej burgu.

E kam ndër sy ujëshitësin tonë, atë burrë thatim e të vrarëli, i cili duke shikuar gomarin, që i iku nga dora, qante si çilimi.

Po pasi kishte fëmijë për të ushqyer, për të mbë shkuan në burg, deshi s'deshi u pajtua të tre-gëtarët fajdexhi. Prapë vazhdoi të mbarte ujë, me gomarin e tij, me atë mushkën e tij, si e quante ai, po që tanë s'ishte më e tij.

Që prej asaj kohe i biri, që ishtë shoku im, nuk vinte më për të lojtur atje te ajo lükurama, ku loznim me fiq të egër, që i bënim si lopë, duke u vënë katër shkopinj dhe dy si brirë.

Çdo ditë e shikoja, të shkonte pas t'et me dy gjyme me ujë në duar. Lodhej shumë, po ç'të bënte, duhej të punonte edhe ai që t'i ndihmonte t'et.

Me asenj e përfshinat e qëndrueshme që
nëpër qytetin e qytetit, që kishte qëndruar
e vijib me qëndrueshme e që kishte qëndruar
është qëndrueshme e që kishte qëndruar
nëpër qytetin e qytetit, që kishte qëndruar

me qëndrueshme e qytetit, që kishte qëndruar
me qëndrueshme e qytetit, që kishte qëndruar

me qëndrueshme e qytetit, që kishte qëndruar
me qëndrueshme e qytetit, që kishte qëndruar

me qëndrueshme e qytetit, që kishte qëndruar
me qëndrueshme e qytetit, që kishte qëndruar

me qëndrueshme e qytetit, që kishte qëndruar
me qëndrueshme e qytetit, që kishte qëndruar



DITA E VERËS

Unë dhe tre shokë të tjerë vumë kush mierlin, kush gjalpin, kush qumështin dhe nëna ime na bëri një byrek për ditën e majit.

N'ato kohërat tona ne të vegjëlit për ditën e majit bënim «refene» dhe delnim shoqërisht jashtë qytetit për festë. Prandaj, atë natë, nga gëzimi s'na zinte gjumi.

Pa dalë mîrë dielli, ne të tre u mblorehëm në oborrin e shtëpisë s'ime dhe po përgatiteshim përt'u nisur.

— Teze, moj teze.

— E, more, çdo?

Djali i ujëshitësit, si zbriti murin e avllisë sonë, erdhi tek ne duke qarë.

— Thuaji, të më marrin dhe mua për ditën e majit. Ne s'kemi miell, as gjalpë dhe mua nënia s'më bëri byrek. — Lotët i kullonin pik-pik. Edhe

mua sot më latë lirë babai, nuk do të vete përujë.

— Ne nuk do të shkonim shumë larg. Që kurishim rritur dhe venim shoqërisht përditën e majit, shumë shumë venim gjer te ara e tim ungji, atje buzë lumit dhe kalonim kohën ndënë rrapi e madh ku në maj gjelbëronte një shesh i vogël mbushur me lule shqerre.

— E marr unë tepsinë me byrek — tha i gëzuar — kur i thamë të vijtë edhe ai.

Unë s'e lashë ta merrte në kokë býrekun, se mos i vinte rendë e i dukej vëtja si hyzmeqar. Po një shoku im më tha që ta merrte se mos i thyhej zëmra. Dhe ashtu bëmë. Se kur i pushuan gjithë ata lot as unë s'e kuptova.

Sa shkuam të rrapi, dielli mbuloi qytetin. Në për bar e n'ato lule dhënhë vesa shkëlgente së bukureze dhe ishte një ditë e bukur, që s'kishtë ku të vente më.

Shtruam një thes të vjetër në shesh dhe në mesi vumë te psinë me byrek.

Sa të vinte koha përtëngrënë filluam të lozim topmeson. Mua atë ditë s'më ecte fare. Gjithnjë në mes, hangra topat e dynjasë.

Lojtëmbe lojtëmbe sa u lëdhëm, pastaj u vëlëm përtë pushuar. Tek po trinim ma erdhë i biri i tregëtarit që i pat marrë gomarën e njëshitetësit. Ai ishte nja tre katër vjeç më i madh se ne.

Më qasni edhe mua, pa ju sjell pepek. Dhemish të pjekur. Mëmë ha kë bërë një qirnështor të madh — dhe këpë durrat përtë ha treguar se isaa i madh ishte edhe babai na thëri një qëngjë.

E dñim që atavë haim shumë i të mirat. Nev s'kishim gjë tjetër vëç atij byrekut të vogël që më

zi do të na harrinte, po na vinte rëndë nga i biri i ujëshitësit dhe s'deshëm ta qasnim.

— S'kemi shumë të hamë, ja këtë byrek të vogël — iu përgjegjëm.

— Po shkoj të marr unë pepek, mish të pjekur, bukë të bardhë, dhe rendi me vrap për në shtëpi. I shkurtër si popël, po e ngjiste me vështirësi të përpjetën.

Thamë t'ikim andej, që kur të vinte të mos na gjente. Po na erdhi likshtë që ta linim atë shesh, të bukur, ku, nga rrezet e diellit, fijet e barit të njomë e ato lule shqerrë, derdhur si dëborë, por krekoreshin me kënaqësi. Hija e rravit loste nëpërmë shesh, nga era, që rrëshqiste me ngadalë nëpërmë gjethet e dëndura. Së largu nga qiparisat, në atë rrugën e sipërme të lagjes sonë, harabelat po këndonin me qindra zëra për pranverën. U shtrimë, nëpërmë bar, si shqerrka, duke vështruar byrekun tonë të vogël.

— Hamë — tha një nga shokët.

— Me që na mori uria, thamë se dreka kishtë ardhur, prandaj u ngritëm, e zgjidhëm futën, ku kishim mbështjellë tepsinë me byrek, dhe e ndamë, në katër pjesë.

Kur po hanim i biri i tregëtarit erdhi dhe na solli një shportë plot me të ngrëna.

— Pse s'më pritet, edhe mua. Shikoni ç'ju kam sjellë?

Deshëm t'i thoshim që ne s'e kishim shok, po nuk i folëm fare me gojë dhe vazhduam të hamë. Ai i nxori sahanet nga shporta, i vuri mbi atë thes, të vjetër dhe na i shtyu me dorë. Neve dhe na i vinte mirë të hanim gjësendi nga ato, dhe na vinte inat, që po na prishte atë drekë të gëzuar. Po na i


prishë drekën më shumë i ati i tij, i cili me shkop në dorë, që prapa, po bërtiste si ndonjë i luajtur.

— Zagarë. — Sa erdhi rrëmbëu sahanet, i futi në shportë, e zuri të na merrte edhe byrekun.

— Është byreku ynë — i thashë unë dhe të katër e zumë tebsinë nga anët dhe s'po e lëshonim.

— Mirë... Shko përpara — i tha' të birit, që u mbluadh si gërthje nga frika. Në njerën dorë mori shportën dhe me tjetrën po e kërcënonte të birin me shkop.

Ne, ashtu siç ishim, me tepsi në dorë, të katër bashkë ndëjtëm në këmbë gjer sà ata u larguan e s'i pamë më.





MËSUESI I FESË

Që prej disa ditësh në shkollën tonë pat ardhur një mësues i ri, i cili si thoshin, më parë kishte pasë qënë hoxhë. Prandaj, me të ardhur, u hap fjala se do të bënim mësim feje. Dhe kjo gjë u muar vesh kur lexuam në orar se ditën e premte ne myslimanët do të bënim në xhami dy orë mësim feje dhe të krishterët në një dhomë të mitropolisë.

Ishte e para ditë e prëmte që po ndaheshim me shokët tonë të klasës. Me qeskë pas krahu, u nisëm pér në xhami.

S'di qysh ta them se si na u duk atë ditë mësuesi i fesë. Ishte një verdhacuq e i fishkur si ndonjë arrë e mykur. Mbante një pallto të madhe, mbi nyjet e këmbës. Nuk mbante krvatë si të tjerët dhe ca më shumë na bëri përshtypje se nuk e hoqi festen, siç bënин të gjithë mësuesit.

Ky mësuesi ynë i fesë kishte marrë me vete edhe një shufër të gjatë thane, të cilën e muarëm, vesh se e donte për ne.

— Zvishni këpucët! — kishte një zë të egër, bobo!

Disa nga ne s'kishin fare ç'të zvishnin.

Pastaj na tha të uleshim.

— Jooo! — na bërtiti kaq shumë sa neve na, bë gjaku ujë.

— Në gjunjë, në gjunjë! se «për allë» e shikoni këtë — dhe na tregoi shufrën — jua thyej kokë!

— Të zestë ne ç'paskemi për të hequr — menduam me vete dhe nga dhëmbjet që ndjenim tundeshim si varka. Këmbët filluan të na mpihen.

— Kjo është «supara» — dhe na ndau të gjithëve nga një libër me ca shkronja si kërraba, të shtrëmbëra mbushur me pika lart, e poshtë,

— Kjo, është «elifbeja», «abeceja» si thoni ju, dhe po s'e mësuat ju mori dreqi. E shikoni këtë? — dhe përsëri na tregoi shufrën. — Po nuk e mësuat, «hezber», «përmëndësh» si thoni ju, jua theva, në kokë.

Qor, — mor, duke ngrënë shufra në kokë e, në duar, pasi na u argasën edhe gjunjët mbi ca rrugë, goza grëmba grëmba, e mbaruam «suparanë» dne, zumë të mësojmë në kuran.

Një ditë, tek po shfletosja kuranin tim, pa

pritur hangra dy shufra tē forta nē taban tē këm-bëve sa që edhe tani i kujtoj.

— Ç'e pandeh kuranin, libër tē këndimit? Puthë, qafir, triherë duke e vënë nē ballë.

Më i miri nē mësimin e fesë qe i biri i myftiut. Atë mësuesi e kishte vënë kujdestar. Bile nē Ramazan e dërgonte tē ndizte edhe kandilet e minares. Ai na kallézonte neve kur mundoheshim tē shtrinim këmbët, që na mbiheshin e na bëheshin dru.

Si mësuam disa «ajete» nga tē kuranit, ai na shpjegoi dhe tē falurit dhe filluam tē përpjekim kokën nē shesh, tē mbërthejmë thëmbrat e këm-bëve, duke mbajtur shtruara gishtérinjtë. Në këtë mënyrë, veç duarve, kokës dhe shputave tē këm-bëve gjeti dhe një vënd tjetër ta thyente shufrën, saherë që bënim ndonjë gabim.

Po punët për mua tani po ngatrroheshin më keq, se ç'mësoja dot përmëndësh. Ca nga ky hall i madh që më kishte gjetur, ca nga ai shkop i maliquar, isha bërë si pul' e shushatur, sa, edhe kur mësoja ndonjë cikë e bëja çorbë fare me ato që më thoshin shokët, se, ditur, e pa ditur, i merrja tjetër për tjetër. Një ditë tek zura tē thoshja «vexhele the nahuqe» duke përzjerë edhe shokun tim Xhelon e mjerë, që po mundohej tē më ndihmonte, thashë «vete Xhelua me qe». Të gjithë qeshën. Vetëm unë dhe Xhelua s'arritëm dot, se mësuesi i fesë na i bëri kokë e duar për krypë.

Të nesërmen, në sy tē gjithë shokëve, ai, si na shau edhe një herë mirë e mirë e na hoqi edhe disa pellëmba tē tjera, na përjashtoi, pasi paskëshim sharë fenë.



«MEN XOXHORNO»

Polici i bashkisë, si veshi rrobat me çapare bojë ari në mëngët dhe jakën e xhaketës, mori me vrap të përpjetën e pazarit. Atë ditë dukej se kishëtë punë me rëndësi, se nuk qëndroi, sipas zakonit, te pijetorja më të dalë të kubesë. Me që ishte burrë i majmë, pa ardhur në qafë të pazarit, zuri të fshinte djersët me mëngën e palltos. Posa arriti te qaf' e pazarit, hypi në pezull të udhës dhe mori drejtqëndrim si njeri në krye të detyrës. Si pa sahatin, nxori nga xhepi një zile dhe e tundi dang-dung-dang-dung.

— C'është kështu?

- Urdhër, urdhër!
- Po ç'urdhër éshtë ky?
- Që të mbyllen dyqanet.
- Pse, mos éshtë e kremte?

U mblodhën plot njerëz për të marrë vesh se ç'po ndodhte. Që atë ditë u hap fjala se në verë. qdo ditë nga dreka gjer në zemërhere, do të mbylleshin dyqanet.

Një burrë me një futë mushama gjer në fund të këmbëve lëvizi kryet me çudi.

— Duhet të përparojmë. Tani vendi ynë ka hyrë në Evropë edhe polici i Bashkisë me shumë fjalë të tjera përpinqej t'u mbushte mëndjen atyre që e pyesnin.

Lolua, me mjekrën e tij të parruar, s'e prishi fare terezinë dhe zakonin e tij. Me një kokë e paça në dorë, për ta shitur, thërriste:

— Kok' e paça të lopur!

— Ama Evropë! — tha një djalë me rroba të ngushta, që dukej të ishte shkollar.

Kur njerëzia u përhapën dhe polici i bashkisë i ra edhe disaherë ziles, dyqanxhijtë mbyllën qepenet me mërzitje. Vetëm Lolua me atë kok' e plëndës në dorë, shkonte poshtë e përpjetë duke përsëritur: «kok' e paça të lopur».

I kënaqur për rendin që u vu, polici i bashkisë u kthye atje n'atë pijetore në të hyrë të kubesë, për të pirë një raki. Pijeshitësi e mbylli derën e dyqanit dhe myshterinjtë mbetën brënda.

— Mir' u bë, ama. S'mund të mbetemi dhe ne pas botës. Tani jemi në Evropë.

— Duhet të mësohem dhe të pushojmë nga një cikë... se, që ta merrni vesh, kryetari i bashkisë ëshë njeri i shitetur, ka parë shumë... «Dëgjo

kütu — më tha — duhet të nisim ta përparojmë qytetin tonë. — Si urdhëron i thashë unë.

«Tani të gjesh një zile, t'i vesh një bisht të drunjtë po të lëmuar dhe drekë për drekë t'i biesh në mes të pazarit. — Si urdhëron i thashë unë. E po kështu vjen përparimi. Sot këtë, nesër atë. Po ju s'e dini se ç'i thonë kësaj pune. Kryetari ma tha vetë: i thonë «Menxoxhorn».»

— Po ç'do me thënë?

— Do me thënë të mbyllësh dyqanë, të biesh të flësh, të bësh vapën, me një fjalë.

— Po ty ta kanë ngarkuar këtë punë?

— Jo, jo. Hëpërhë; pa do të mérret një nëpunes tjetër.


Të nesërmen për këtë punë të re shkuan në bashki pesëdhjetë vjetë.

Qyteti ynë mori pamjen e një qyteti të Evropës dhe njerëzia zunë të pushojnë e të gërhinë.

Të gjithë u bindën; vetëm Loluia i shkretetë nuk u bind.

Atij i binin këmbët poshtë e përpjetë pazarit me kokë e paça të lopur në duar. Çdo ditë, edhe në «menxoxhorn», për të gjetur myshterinj ngjirej duke bërtitur:

— Kok' e paça të lopur.



NDJEKËSI I QENVE

Në lagjen tonë ishte një qen, të cilit nga ngjyra e qimes ne të vegjelit i kishim vënë emërta «kanella». Kanella e shkretë, me që s'kishte të zot, sorollatej sokakëve dhe kohën e drekës e shkonte të kasapët për të xhvatur ndonjë copë mushkëri. Herë-herë humbiste ditë të tëra. Neve na vinte keq se ishim mësuar me të dhe, kur hanim bukë te porta, çoku i jepnim edhe atij nga një çikë. Qe një çudi me të. Kanella rrinte në bisht dhe na shikonte, si njeri, në dritën e syrit.

Po që kur dolli urdhëri i bashkisë për të helmuar qentë kanella s'para shkontakte andej nga kasapët.

Polici i bashkisë në fillim qentë i zinte met me nyje në krye të një shuli të gjatë. Qentë ikë e polici ndiq nga pas me vrap. Po, si shkuancë kohë, ata u mësuan. Që për së largu, sa delte polici i bashkisë nga kasapët, bëheshin erë. Atëherë e kupëtuam se pse kanella e shkretë e lagjes sonë humbiste ditë të tëra.

Thoshin se polici i bashkisë ishte njeri i zgjuar. Për këtë arësyen sado kryetarë bashkie, që ishin

këmbyer, këtë nuk e kishin trazuar! Edhe pse pinte ngā një herë jashtë rrëgullit, nuk e qértonin se e bënte herë nga gëzimi që mbyste shumë qen, herë nga zëmërimi kur ndonjë i shpëtonte e duke rendur pas tij ja nxirrte gjuhën një pëllëmbë. Sot — e qértoi një dítë kryetari i bashkisë — kam parë një qen në pazar.

— Si urdhëron...

— Ç'si urdhëron, pse s'i ke bërë derman?

— Është vështirë, zoti kryetar. Sa më shikojnë zhduken...

— Shiko, mos ta shoh më atë qën.

Helm e pikë, për të mbledhur veten, shkojnë n'atë pijetoren atje më të hyrë të kubesë, për të hedhur ndonjë gotë.

— Më rai havale një qerrata qen, më turpëroi fare. Mbushma dhe një.

— Bëni marifetin...

— E, e, nuk e di ti ç'shejtan qen është. Poku ma merr erën?

— Mos është një qen si në kanellë?

— Dora vetë.

— Hidhi një copë mëlçi me helm në ndonjë nga këto teneqet e kasapëve që hedhin plehrat.

— Mirë thua!... Nga rakia zbërtheu kopsat e xhaqetës dhe fshiu gjoksin lehtas me shami.

Ato dit, në qytetin tonë, na pat ardhur edhe prefekti i ri, i cili na paskësh, edhe ky, një qen si në kanellë, tëpke si ai i lagjes sonë po që qe mësuar aq shumë pas të zot sa s'i ndahej edhe në zyrë.

Të nesërmen, polici i bashkisë, i sigurtë se s'do t'i shpëtonte, priste kanellën atje në qoshetë tyrbesë te kubeja e pazarit.

Prefekti ndhe kryetari i bashkisë, që kishin dalë për-të parë tregun, bënë ballë edhe ata te ku-beja.

Qeni i prefektit, megjithëse qe mësuar mirë, prap se prapë gjeti rastin t'i fuste turinjtë nëpër skutat e dyqaneve. Kur erdhi te kasapët, mëlcia n'atë teneqe të pisllëqeve i pëlqeu, dhe, si i babëzitur, me dy tri të gëlltitura e shkoi në bark.

Pa bërë mirë dhjetë çape u shtri dhe zuri të tundë këmbët. Nga goja i delte shkumë.

— Ou! — ja bëri prefekti me habi.

— Si urdhëron, zojti prefekt, edhe ky më kishte mbetur iu përgjegj polici i bashkisë me buzëqeshje, duke marrë drejtqëndrim. — Si urdhëron...

— Cili gomar e ka dhënë këtë urdhër?... —
pyeti prefekti....?

Kanella e lagjes sonë qe me mënd, ajo s'delte nga pazari, as nga kësafat. Po tanë edhe sikur të delte, s'do ta pësonte më nga polici i bashkisë, pasi këtë e pushuan nga puna, dhe për të nxjerrë bukën e gojës s'kishte më kohë as të ndiqte qenëtë as të pinte ndonjë raki, as të thoshte më «surdhëron».

POSHTERIM

Kishim shumë që nëra s'na gatuante tjetër gië përveçse trahana të tharët dhe bukëvale me dhiozmo. Im atë, sado që rrinte i mërzitur, nuk na qërtonte asnjëherë po të thoshim ndonjë fjalë edhe sikur të mos na pëlqente gjella. Ç'kishim që të kërkonim tjetër?



Në ato kohëra nuk i paguanin në rregull nëpunësit dhe, me ç'mbaj mënd unë, atëhere ai kiste tetë muaj që s'po merrte rrogë.

Një natë u gdhimë pa bukë. Furrxhiu s'na jep-te më veresie dhe në treg s'na besonin më. Të nesërmen e asaj nate, im atë më mori edhe mue e shkuam te drejtori i financës. Më kujtohet si tani kjo ngjarje e hidhur dhe poshteronjëse, që năndodhi në zyrën e drejtorit të financës.

Sa ngjitëm shkallët e prefekturës u drejtuam në zyrën e drejtorit të financës. Im atë u kopsit mirë e mirë. U mat dy tri herë t'i binte derës; po u pendua dhe filloi t'u vinte rrötull parmakëve të drunitë në koridor.

— Po hajde, baba.

— Dale, more bir... Pa ecë e shih nga vrima e çelësit, se mos ka njeri.

Unë jo vetëm që shikoja nga vrima e çelësit, po vija edhe veshin.

— Eja, eja — i bëja me shenjë.

Ai ngurronte.

Më në fund bëri zemër. Tak, tak derës dhe e çeli për gjysëm. Unë e pashë drejtorin e financës, që kishte hedhur këmbët mbi krahët e karekllës: dhe loste me to si i vogël. Me një brisk kruante thonjtë.

Me që nuk e gjetëm në gjëndje të mirë, ai nal priti me hundë.

— E?... Ç'do?

— Kam një kohë të gjatë që s'po marr rrögën, zoti drejtor. Ti dhe perëndia. Kam fëmijët pa bukë... Më jep vetëm një rrrogë.

— Po s'ka arka...

— Si urdhëron... Po...

— Ç'të të jap?... Arka është e zbrazët. — Duke folur vështronë thonjtë se a i kishte rrumbullakosur mirë.

— Jam pa bukë... ju thashë.

— Arka s'ka... a e merr vesh?

— Si urdhëron... po shpëtomë, zoti drejtor, zëre se m'i jep për shpirt... Vur dorën në zemër... Edhe ti je baba.

— Na, të të jap një letër — dhe nisi të shkruajë... — Ai i blen rrogat më lirë... E kam të njoftur e nuk ma prish mua... — vazhdonte të fliše dhe të shkruante. Kur po paloste letrën, në zyrë hyri sekretari i prefektit.

— I dhashë urdhër arkëtarit t'ju paguajë...

shko në arkë — i tha drejtori i financës atij dhe t’im eti i dha letrën e palosur.

— Im atë si e pa mir’ e mirë letrën, ja përplasi mbi tryezë.

— Shkojmë! — Më mori për dore dhe dolëm pa mbyllur fare derën.

— Po tani, baba, ç’do të bëjmë?

Im atë më vështroi në sy, më shkoi dorën në flokë. Ndjeva se ai atë çast po vuante shumë. Dora i dridhej.

Nuk i kishim zbritur mirë gjysmët e shkallëve kur ai u kthyte përsëri dhe duke më lënë mua prapa, rrëmbimthi i ngjiti shkallët nga dy e nga tri. U trëmba shumë se mos im atë më pësonët gjë. Shkova pas tij me gjak të ngrrirë.

Hyri prapë te drejtori. I dërmuar sa s’mbahej dot më, që bërë në fytyrë si gëlqere e murit.

—Më fal, zoti drejtor, të lutem — dhe duke marrë letrën mbi tryezë i tha: «të falem nderit» e doli.

E vura re drejtorin e financës, që bëri buzën në gaz dhe mori nga paqeta një cigare, e ndezi dhe e thithi duke e lëshuar tymin nga goja rrötulla-rrötulla.



MERRNI DRU

— Merrni dru... merrni dru!

Këtë zë e dëgjonim në rrugët e qytetit tonë e ishim mësuar me të dhe kako Froson e njihnim, se të gjithë kishim blerë prej saj nga një barrë dru.

Kako Frosua qe plakë pa njeri dhe e varfër. Që kur taksidari i kish marrë edhe dy dhité e vetëme pëlla me gjithë kecér sepse s'pat shlyer vergjinë, kish mbetur si peshku pa ujë.

Prej asaj dite fshatarët e ndihmonin, po duke qënë kohërat të shtrënguara, asaj i vinte rëndë

t'u binte më qaffë, prandaj bënte një jetë, të vësh-tirë.

Një të hëne, në një të ftohtë, të madh, ajo solli përsëri një barrë me dru.

Zëri i ngjirur: «Merrni dru... merrni dru» u dëgjua si ngahërë, në lagjen e parë të qytetit, në të përpjetën e pazarit, nëpër rrugica të ngushta me kaldrëme të prishura. Herëherë me hidhërim, qëllonte me një shufer gomarin e saj.

Në pazarin e druve priti e priti sa u lodh.

Asnjeri s'e pyeti sa i shiste, asnjeri s'e pa si ishte barra. E mërzitur, e vuri përpara gomarin, dhe u fut nëpër treg.

— Merrni dru... merrni dru.

Në këtë kohë një turmë e madhe me gra-dhe burra po drejtoheshin për në prefekturë.

— Duam bukë! Duam bukë!

— Ç'thonë këto gra kështu për bukë?

— Kërkojnë bukë se s'kanë.

— O Zot! As këtu s'paska bukë! Ysh! — dhe i ra fort me shufër gomarit, sa ky, duke i mble-dhur vithet me dhëmbje të madhe, nxitoi me vrull.

— Merrni dru... Merrni...

Gjithë atë ditë gjer në pasdrekë kako Frosos i ra bretku së bredhuri e së thirruri «merrni dru... merrni dru...»

Përpara derës së një shtëpize në lagjen e për-tejmë të qytetit tre kalamanj po qanin.

Njëri thërriste me ngashërim. — Nëne, nëne, po hajde, moj nëne!

— Ç'keni, jet-o?

— Po mbërdhimë. Nënia ka shkuar për karthia e akoma s'po vjen.

— O perëndi, ç'ditë kemi arritur! — La shufrë në shesh dhe shkarkoi gomarin.

— Merrni t'u bëfshà.

Të tre fëmijët u derdhën, si t'uritur për bukë, dhe një nga një i futën drutë brënda. Asnjëherë s'kishte qarë kako Frosua si atë të hënë dhe, si mori gomarin për kapistre, zbriti poshtë, kapërxeu urën e lumi dhe humbi në hapësirën e fushës plot njergull.

KALLEZIME TË KOHËS SONË

QËNDRO NURI

Ditët e para të verës së vitit 1944 Qëndro Nurin e kishin mërzitur mjaft.

Lufta, që kishte filluar në Nivicë-Bubar, në Gjorm e Beun, në qafën e Kreshtës e sipër në Dhëmlan, kundër pozicioneve të brigadës së gjashtë, tani po shtrëngohet shumë. Gjermanët ishin avitur nga Borshi dhe me forca të mëdha po i hynin Kuçit.



Ushtimat e paprera të topave, që po afrohen shëtin. Në krye të divanit vështroi edhe një herë koburen varur në mur. Gjithë shokët e tij e kishin nga një pushkë. Po ai edhe atë malihet greku me veshë, që e kishte shumë për zemër, ja pat dhënë dhëndrit të tij Mite Zotos, pasi i kishte pëlqyer.

Pas martesës të së bijës së vetme, Sorkës, me Mite Zoton, Qendro Nuri, së bashku me plakën,

merreshin me ato pak dhi, që kishin dhe me dy ara poshtë buzë pérroit. Po tani, si kishte ardhur puna, njeriu s'kishte më siguri. Gjermanët ç'gjenin pérpara fshat i vinin flakën. Edhe Bataljoni i dytë i brigadës qe tërhequr nga Jelini e nga fusha e Vanovës së Pilurit.

Kishte ardhur koha që dhe Qëndrua me plakën t'iknin e të fshiheshin në pyll dhe ç't'i gjente le t'i gjente me shokë bashkë. Dhe ai atë mëngjes qershori, si nisi pérpara plakën, pér vete mendoi të shkonte nga e bija, Sorka. Vuri koburen në brez, festen kadife në kokë dhe u var poshtë rrëzë një lirishteje, ku kalon rruga pér në lagjen e pértejme të fshatit.

* * *

Në kopshtin e shtëpisë Mite Zotua dhe e shqja, Sorka e Qëndro Nurit, i mbuluan plaçkat e shtëpisë mir' e mirë me murriza. Si mbaruan Sorka, duke fshirë djersët me fundin e pérparëses, të cilën e pat veshur ditën që u gëdhi nuse e shkojnë çësmë pér të marrë ujë, u ul te shkallët e derës së shtëpisë. Faqet i qenë ndezur.

Një krism' e vazhdueshme mortajash dégjohej thellë në lumë të Kuçit. Sorka zuri veshët me të dy duart dhe, duke pulitur qepallat, iu mbushën sytë me lot e psherëtit. Këmishët e nusërisë; tri pérparëset dhe çorapet zoga-zoga, që s'harriti dot t'i vishët, sëbashku me të shoqin atë ditët mbuluan atje n'atë gropë. Shamitë, fustanet, këpucët, kostumi i dhëndërisë i të shoqit, tani do të bëheshin baltëra, do t'i lagte shiu, ose kushedhë

mund t'ua merrnin ose mund tē digjeshin bashkë me shtëpinë.

Tek po rrinin kështu tē helmuar, tē dy bashkë burr' e grua, te dera e oborrit u duk Qëndro Nuri. Ai s'e kishte ndjerë fare udhën, as atë tē përpjetë tē Qafës mbrete, që ta bie në majë tē hundës. Pa u pyetur fare me ta, pa pritur tē çlo-dhej, u foli:

— Shkojmë. S'keni ç'mendoni më. Puna është tē shpëtojmë kokën, pa mallin e gjënë e vëmë prapë. Dhe, duke e zënë tē bijën nga dora, i tha: — Ngreu! S'kemi ç'të presim më. Bukë ke marrë në trastë? Ngarko edhe një torbë miell dhe nisemi.

Sorka përgatiti tē dy trastat. — I shoqi rrinte pa folur.

— Hajdeni! — Qëndro Nuri e mori njérën trastë dhe e hodhi pas krahut.

— Ju ikëni. Unë kam radhën sonte tē bëj roje, kushedi ndoshta kalon ndonjë njësit partizan dhe do t'a drejtoj. Paštaj... janë edhe tē së-murët. — Mite Zotua mylli malipherin e shkurtër me veshë dhe i vuri sigurecën...

— Ti shko. Prapë do tē takohemi, vazhdoi ai — dhe iu qas Sorkës, i mori dorën e, duke e shikuar në sy, e përqafoi.

Qëndro Nuri u shtëmieng dhe ktheu kryet. Ai e dinte se koha ishte e rrezikëshme dhe dhëndëri duhej ta plotësonte detyrën... po edhe Qëndro Nuri duhej tē mendonte për kokën e atij. I ri ishte e s'po e gëzonte fare dhëndërinë. Edhe përvete tē tij, Qëndrua, kur që martuár, e përkëdhelte tē shqegen me dashuri dhe sa herë kthëhej ajo nga çesma, me atë përparëse tē kuqë, delte te por-

ta dhe e priste. Po ai me tē shoqen kishte kaluar një jetë tē tërë. Tani e bija, as tre muaj nuse, e kishte fshehur pajën në një gropë; dhëndëri me maliherin e tij në krah kushedi mund tē vritej. Kur e martoi tē bijën, megjithëse s'ishin kohërat, bëri dasmë, jo pér tē gëzuar tē bijën, po më shumë Miten, tē rritur jetim e njeri pa njeri.

U kthye dhe i vështroi tē dy, që po rrin pa i lëshuar dorën njeri tjetrit.

— Ju ecëni me shëndet. Po rri unë roje! — Pastaj me tē shpejtë, duke hequr koburen nga brezi, i mori dhëndërit maliherin dhe gjerdanin. — Këtë merre ti, — i dha koburen.

— Baba!

— E di ç'do tē më thuash. Do tē përgjigjem unë pér ty. Sa pér rrugët, unë i di me pëllëmbë.

U mat tē fliste përsëri Mite Zotua, po Qëndro Nuri ja preu fjalën.

— Unë e kam menduar dhe njeri nuk do tē më thotë se kam fëjier. Ikëni me mëndje tē mbledhur dhe mbronì kokën.

Qëndro Nuri, si ngjeshi në brez gjerdanin me fyshekë, nga port' e shtëpisë po shikonte Miten e Sorkën, që dukeshin akoma poshtë rrugës së fshatit dhe nuk u largua gjersa ata humbën brënda pyllit tē dëndur.

Krisma e mortajave vazhdonte.

Vandaku me driza s'të linte më përshtypjen se atje ishin fshehur rrobat e nusërisë së Sorkës, tē bijës së Qëndro Nurit dhe tē dhëndërit tē tij, Mites.

Duke mbyllur kanatet e portës Qëndro Nuri e pa edhe njëherë atë vandak me driza:

— Po, bijtë e mi, ju keni tē drejtë tē rroni

më shumë se unë — dhe mori atë rrugë që ai e dinte më mirë.

... Praparoja e bataljonit të dytë, si u tërhoq nga pozicjonet e fundit të Pilurit, ndajnatëhere po kalonte qafën e mbretë.

— Shokë, ... o shok!

Partizanët menjëherë u ndalën dhe u shtrinë barkas.

— Shokë, o shok!

— Ej, mor kush je? — i foli një partizan...

— Jam unë, Qëndrua... Qëndro Nuri...

Partizanët e bataljonit, që kishte qëndruar në Pilur, e njihnin Qëndro Nurin dhe i folën:

— Hajde lart.

Qëndro Nuri u afërua dhe u poq me ta.

— Ejani pas meje të bijem këtij shtegu tjetër, t'i lëmë rojet e para gjermanë në krah.

Si kaluan ca, praparoja u ndal përsëri.

— Këtu të rrimë një çikë; jemi afër qafës së Drrasës.

Nata ishte e errët. Partizanët u çlodhën pak; u nisen prapë. Vendin e dinin dhe kjo u jepte më shumë zemër. Sa herë i kishin kaluar ato harca.

— Tani kini mëndjen: jemi tamam atje ku do të kalojmë — u tha Qëndro Nuri. — Më jepni pesë partizanë të dalim këndej për nën qafë. Këndej është rreziku.

Ashtu bënë.

Sa kaloi qafën e Drrasës, praparoja e bataljonit, për nën të u dëgjuan automatikë e bombat e dorës e bënë flakë vendin. Lufta nuk zgjati shumë ...

Mbi shkurret sipër xhadesë u dëgjuan këmbë.

Në mëngjes herët praparoja arriti bataljonin në Papadhi.

Qëndro Nuri, me kryet mbështetur mbi një çantë partizane, mbuluar me një kapotë gjer në kokë, po merrte fryshtë me zor. Të gjithë shokët afër po përpinqeshin t'i vinin në ndihmë.

— Eshtë më të shuar, — tha një partizan.

Qëndro Nuri atë qast hapi sytë e rëndë nga dhimbja. Iu duk një të qeshur nëpër buzë, pastaj vari kryet dhe vdiq.

“ Pas një javë, në Kuç e kujtuam Qëndro Nuri, që na mallëngjeu me zëmrën e tij, kur Mite Zotua na tregoi se c'kishte ndodhur atë pasdreke me të.”

“ Lulet çelin çdo vit atje në Papadhi.

“ Juhu! Juhu! Juhu!

“ Çe vini më i thotë që do t'i bëj?

“ Gjatë kësaj vjetë, më i lindja
është një vajzë e lindur,
një vajzë e lindur,
një vajzë e lindur,
një vajzë e lindur,
një vajzë e lindur,

“ E s'ka vajzë e lindur,
e s'ka vajzë e lindur,
e s'ka vajzë e lindur,

“ E s'ka vajzë e lindur,



NJERËZ TË THJESHTË

Një natë partizanët e kompanisë sonë po flinin në lëndinën e një manastiri të vjetër. Zjarret kishin filluar të shuheshin dhe ne nga të ftohtit ishim mbledhur njeri pas tjetrit. Vetëm Velua që e kishte pseudonimin «Shtataniku», korjeri i kompanisë, akoma s'po flinte. Afër zjarrit po merrej

me një opingë. Duke u munduar ta lidhte me një copë tel, sa të mos i delnin gishterinjtë, shterngonte buzët dhe i mshonte telit për të shpuar faqen e opingës.

Në haurin e manastirit, celula e partisë vazhdonte mbledhjen.

— Të gjatë e paskan këtë mbledhje — tha më vete Velua — dhe e la opingën e po shikonte në dritare të haurit dritën e zbetë e tërë tym të bish-tukut të vogël. Pastaj hahej përsëri me atë tel, që i shtrëmbërohej dhe e mundonte.

— Hë të marrtë dreqi, se më plase — dhe e tërhoqi lart.

Komissari i kompanisë, si mbaroi nga mbledhja, doli te dera e haurit.

— E mo shoku komisar, akoma në mbledhje? Ç'vendosët gjë? — e pyeti Velua, dhe me dorë shtyu një urë, që po shuhej, pastaj me një gur e ktheu telin poshtë.

— Tani u bë kjo si kundrat e pazarit.

— Ç'e do se ç'e bëre. — Komissari u ul afér-zjarrit dhe i vërente me kujdës opingat e Velos, që i kishte bërë tërë tel... — Me këto mund të vesh edhe në Vlorë, në mos gjer aty afér.

Flokët i binin si baluke. Era herëherë ja shpërndante. Duke shikuar opingat e copëtuara të Velos, edhe ai sillte nëpër mënd atë udhëtimin e gjatë që kish bërë në nëndorin e vitit 1943, zbatthur, nëpër zhur të Kuçë e në qafë të Gomares. Sapo kishte dalë partizan. Këmbët ja kishte cop-tuar zalli i hollë që të pret si thikë.

— Ama opinga ë? — Si kundra i paska bërë?

— Ç'të bësh, shoku komisar, kur s'ke të tjera... Na u grisën edhe ato që patëm... Të mira u bënë

ama, ë? — dhe i kthente e i rrrotullonte me duar.

— Vetëm që s'kanë takë.

Sipas zakonit filluan të bëjnë nga një cingar. Duhani, i grirë me dorë, i bërë pluhur në xhep, më shumë shkundej se dridhej.

— Një para s'bën, po hiqet ama.

Këmbët e Velos, tërë dregëza, kundruall zjarrit dukeshin si dy popëla.

— Po udhëton dot me këto opinga e me këto këmbë? — e pyeti komisari, duke ndezur me një urë cingarin.

— Mos kam të tjera? Gjer tanë me këto kam udhëtar — dhe zuri t'i mbathte. — Pastaj korjer jam unë. Këtë punë më ka caktuar partia dhe duhet ta bëj me këto këmbë e me këto opinga. Partizanët presin lajme, presin urdhëra. Po të mos jemi dhe ne korjerët kush do t'i bëjë këto punë?

— More Velo, s'ma ke thënë ndonië herë se qysh të ka mbetur ky pseudonim «shtataniku».

— Shtatanik më bëri nëna, se u tremb nga një pelë hergjele e agajt, e cila për pak e vras. Dhe e di ku kam lindur? Mu prapa shtrungës. Babai, thonë, u mat ta vriste pelën po e mbajtën ca shokë. S'ka gjë edhe kështu shtatanik, me këto këmbë e me këto opinga, do t'ja ha hallvanë agajt; mos ketë merak, se armik është bërë.

Si lidhi opingat dhe veshi kapotën zuri të ngrihej.

— E? Do të më japësh ndonjë letër? Do të nisem?

— Po do të shkosh larg.

— Larg, afër, tanë kësaj pune i kemi hyrë.

— Po, more Velo. Larg ose afër kësaj pune i kemi hyrë dhe do ta shpiem gjer në fund. — Pas-

taj nxori nga çanta një letër të mbyllur. — Këtë do ta shpiesz në Cepo. Po shpejt.

— Për atë mos u bën merak. I sheh këto këmbë si rodhan? S'duan t'ja dinë.

Urët e zjarrit, që tani i kishin mbledhur grumbull, bënin flakë. Ata të dy e shquanin njeri tjetrin qartë. Velua filloi të mbërthejë kapotën, që i vinte gjer afër syrit të këmbës.

— Mos ki merak, shoku komisar. Vdekje fashizmit!

— Liri Popullit!

Komisarin, aty afër partizanëve, sa u mbështet, e zuri gjumi.

* * *

Nënë Marina, një plakë me shtat të pakët e e zbetë në fytyrë, kishte dalë te gardhi i kopështit buzë rrugës kryesore të fshatit dhe po bisedonte më një fqinjën e saj.

— Pa dale, moj motër, të shohim çështë ky shoku, që po na vjen — dhe duke hequr një degë mërquinje, hapi një shteg e i doli përpara.

Velua mezi mbahej në këmbë. Sa u afrua te gardhi i shtëpisë së nënë Marinës, tërroqi me rrëmbim tabanin e opingës. Ajo s'u këput, po duke u rrotulluar, iu mblodh te ura e këmbës e po e pengonte.

— Vdekje fashizmit.

— Liri popullit, jet-o. — Teto Marina e uli në shesh trastën që kishte pas krahut dhe nisi ta pyesë këtë partizan, që po vinte në këtë kohë të keqe, se si po dukeshin punët:

— E more shok, ç'na thua gjë?

— Shumë gjermanë, nëne. Po dhe partizanë shumë. — Si u ul e u mbështet pas ledhit t'u-dhës, u përpoq përsëri se mos lidhte dot opingën. Nënë Marina po i tregonte Velos se tani punët po shtrëngoheshin shumë dhe lajme të këqia vinin nga të gjitha anët. Gjermanët po hynin në Pagon. Në fushën e Dropullit e në Tepelenë thoshin se ishte parë ushtri e madhe. Fshatarët një rrezik i madh po i priste. Qe hapur edhe fjala, se një çoban kishte parë shpatullën dhe kishte thënë se do të bëhej gjak dhe shkatërrime të mëdha.

— Ja, kështu edhe këto fjalë janë përhapur, more bir. Po neve s'na e do zëmra. Si thua ti? Të jetë kështu?

— Po dhe mund të jetë, moj nënë. Hasmi se mos ka ardhur për të mirë.

— Po luftë s'po bëhet.

— Do të fillojë. Ja, kështu së bashku do t'i bëjmë ballë, sos do ta lëmë të na shkelë e të na pocaqisë. S'na e del njeri neve, jo! Ne do ta fitojmë luftën.

Nënë Marina dhe Velua biseduan një copë-herë të gjatë për të gjitha këto që fliteshin e dëgjoheshin. Ai e kishte kapërcyer lumin e Drinos me vështirësi dhe qe lagur shumë. Opingat e tij, ato opinga, që i pat bërë me tel si kundrat e pazarit, i qenë shqepur sa s'kishin ku të mbaheshin më.

— Si zor, — mendoi nënë Marina — të vejë me këto opinga. Gishtérinjtë e këmbës, të zbrujtur e pa pikë gjak, si të vdekur, ja këputën shpirtin.

— Pa ngreu të shkojmë një herë në shtëpi të hash një kafshore bukë e të të thaj rrrobat.

Te konaku i vogël nënë Marina ndezi zjarr të

mirë dhe i thau rrrobat e i dha bukë të thekur e një tas me fasule.

— Po nisem tani, nëne.

— Prit — i tha ajo dhe nga trasta nxori një palë opinga llastiku, pothuaj të paveshura fare.

— Merri këto, bir. Ti e shikon shtëpinë, e kam kakruk. Na i kanë marrë plaçkat. Merri jet-o, e t'i grisësh me shëndet...

Lotët që filluan t'i mbushin sytë nënë Marinës ja prenë fjalët. Ajo s'ishte më e zonja t'i thoshte edhe shumë fjalë të tjera, vetëm vazhdoi:

— Janë të tim biri, që nuk arriti ti vishte...



PO LIND DIELLI

Shoqen Persefoni dhe Bulen i kishin arrestuar. Nga dritarja e vogël e qelisë së burgut, Bulja, një vajzë thatime dhe e zeshkët si fik i rreshkur, po kundronte qytetin, i cili nga errësira është dukej i zymtë. Tek-tuk hëna, përmes reve, i zbardhët si argjent çatitë e gurta të shtëpive.

Rojet e ballit venin e vinin përpara qelisë.

Të dyja shoqet herë pas here vështronin njerëzra tjetrën në dritë të syrit.

Rinia e tyre e hidhur u delte përpara si një film. Bules i kujtoheshin tantellat e holla, që punonte për të fituar bukën e gojës dhe i shikonte

... Dera e qelisë u çel. Një grup ballistësh i mori të dyja dhe, si u lidhi duart, i nxori për në sheshin e kalasë.

Agimi zbardhëllonte dhe rrezet e para të dieilit shkrepën sipër maleve.

— Persi po lind dielli — i foli Bulja.

— Po. Po lind!



Ciroi, i vogël sa një grusht, kur pat ardhur në bataljon, partizanëve, sa e panë, u erdhin dikshtë për të; nofulla e poshtme e shtrembër; jo vetëm që e shëmtonte, po edhe e pengonte në të folur. Vetëm sytë e tij të shkruar, që i lëviznin me shpejtësi, i kishte fort të bukur. I rritur jetim, pa farë e fis, gjersa u bë shtatëmbëdhjetë vjeç kish-te ngrënë kushedi sa pëllëmba fytyrës nga agai, te i cili qe pajtuar çoban.

Ciroi u mësua shpejt në bataljon dhe partizanët e donin shumë. Ishte i përpikët e i papertuar. Sa herë e kërkoje: urdhëro e në këmbë e kishe.

Në luftën e Dishnicës ai u plagos rëndë. Me gjithëse infermieri i rrinte mbi kokë, duke e mjekuar e duke i dhënë zemër, Ciroi po keqëso-

hej më shumë. Një ditë iu lut zonjës së shtëpisë të therriste komisarin të vinte se e donte për diçka.

Komisari, tek po ngjitëte shkallët, vuri re infirmierin, i cili mblodhi supet me dëshpërim.

Ciroi, shtrirë mbi një minder me bar, dukej si i vdekur.

— Shoku komisar, kur do të mblidhet celula e partisë?

— Nesër.

— Nesër? Sa keq. Unë s'kam mundësi të vij. Ti më shikon si jam. Sa keq!

— Ti do të shërohesh dhe celula prapë do të mblidhet.

— E di... shoku komisar. Doja të të flisja shumë, po unë s'kam më fuqi. Të lutem vetëm për një gjë: thuaju shokëve; aty në mbledhje, se unë kam bërë një gabim. Nuk desha, po pata uri. Ha pa një koshere bletësh. Më beso se një copkë pite kam marrë... Le ta gjykojë vetë kompania

Ndjeu një lehtësi dhe faqet e tia të zbeta i përshkoi një nur i bukur.

Komisari, i ngashëryer, s'ishte i zoti më t'i thoshte asnjë fjalë. Duke dalë, këmbët iu prënë dhe shkallët i zbriti si i lodhur.

E kam ndër sy Ciruan, kur e varrosën në një bregore të vogël afër një lisi të madh. Zëvëndës-komisari i kompanisë, pasi partizanët shtinë një batara pushkësh, gdhëndi në trupin e atij lisi të madh këto fjalë: «Ciroi, anëtar partie».



GURI I NUSES

Një zë po del nga grykë e Mezhgoranit

Një shkëmb i kuq, në fshatin tonë, ngrihet lart si heshtë. Atje bien për herë të parë rrrezet e diellit. Po të qëndrojnë retë mbi të, fshatarët thonë se do të prishet moti. Në mënyrë të zakonshme, në shumë vise këta gurë i quajnë «Guri gjatë» po ne këtë «gur të gjatë» tanë e quajmë «Guri i nuses». Dhe ja t'ua kallëzoj pse i vumë këtë emër.

Në kohën e luftës nacional-çlirimtare në fshatin tonë rronte edhe plaku Zenel Bardhi, që kishtë një djalë dhe nusen e djalit. Djali i Zenel Bardhit ishte i mënçur dhe trim. Nga mënçuria flokët i

qenë zbardhur si ergjëndi; nga trimëria sytë i lëshonin xixa si yje. Nusja ishte e bukur si hëna, me këngë në gojë si dallëndyshe. Lulash i quanin djalin, e Zogë nusen e djalit. Dhe plaku gëzohej.

Djali doli partizan. I ati i veshi gjerdanin e vet, i dha pushkën dhe uratën.

Ja njohën Lulashit partizanët trimërinë; dhe u gëzuan kur e bënë komandant të tyre. Ai, duke kënduar, bëri luftëra të mëdha.

Mendonte Zoga për Lulashin dhe mësonte këngët e partizanëve.

— Moj nuse — i foli një ditë plaku Zenel Bardhi — pse s'na këndove gjëkafshë.

Ajo rrinte atë ditë e helmuar. Larg, topi po kërciste. Lulashi kush' e di ku ishte.

— Po bëhet luftë, baba, dhe topa shumë bien.

— Çdo ditë luftë bën Lulashi dhe lufta luftë është. Këndò, moj bijë, se mirë i bën kënga trimit.

Dhe Zoga nisi këngën si përpara. Plaku Zenel Bardhi e dëgjonte e ngazëlllohej.

— Të lumtë goja, nuse Zoga.

Ajo uli kryet e u skuq, po sytë e saj të zës iu mbushën me lot.

— Baba, do të vazhdojë shumë lufta?

— Lufta? Luftë është, moj bijë. Kur të zë vatrën hasmi dō luftuar.

— Po Lulashi do të kthehet?

— Posi, do të kthehet, — iu përgjegj me ngashërim Zenel Bardhi.

Mbi dimitët e kuq xhanfes të nuses rrezet e diellit xixëllonin.

* * *

Në «Gur të gjatë» ra përsëri dielli. Lufta vazhdonte në Grykë, në Këlcyrë. Si ngaherë, Lulashi në ballë të çetës i shpëtoi shokët nga rrithimi. Po Lulashin e mori një plumb. U mblodhën partizanët dhe, sipas zakonit, i ngritën një këngë. Në Grykë e përtej Vjosës u hap me rrëmbim kënga për Lulashin.

E mësoi këtë këngë Zoga dhe e këndoi me mllëngjim:

U mblodhën retë në «Gur të gjatë».

— Do të prishet moti nuse; nxito të mbledhëm drithët.

Zogës duart s'i punojnë. Në zemër ndjente një përtim.

— T'ja marr këngës — tha me vete — ta gëzoj babanë e mjerë.

Nga fusha nëpër fshat gjëmoi kënga për Lulashin, të birin e Zenel Bardhit, të atij partizani me flokë të bardhë si ergjënd.


* * *

Kush ngjitet lart me vrap nga «Gur i gjatë»?

— Pa prit, moj nuse, bija ime, Lulashi prapë do të na kthehet.

Plaku Zenel Bardhi atë nuk e arriti dot. Mbi «Gur të gjatë» vetëm një shami e këqe lëkundëj në erë.

...Partizanët erdhën përsëri në fshat dhe, si gjithmonë ja muarën këngës.



FITORE

...Gojë më gojë, si vetëtimë, u hap fjala dhe arriti në çdo pozicion të partizanëve; «Tirana duhet qeluar me çdo kusht».

Dhe shpejt, si vetëtimë, arriti në Shtabin e Divizonit fjala e partizanëve: «Do ta çlirojmë!». Në çdo pozicjon partizanëve u gfonë zëmra. Në qëndrën e qytetit, gjermanët, si qëntë të tjeruar, shkuleshin pa torua.

Diku dilnin ndonjëherë më tej, po nuk kthehen prapë.

E kush i linte?

Partizanët qëllonin mirë. Kishin kohë që ishin stërvitur të shtinin.

Ditën, nga ana e çliruar e Tiranës, njerëzit piqeshin me partizanët, bisedonin me ta, i përqafonin dhe u jepnën plot të mira.

Po ata e shikonin qetësinë të prishur, pësh-përisnin se si do iu vente puna. Ndonjëri, që e mbante lart dhe hiqej sikur kupëtonte nga lufta, thoshte:

— Eh! punët e luftës janë gjëra të zgjatura. Satra trazosh një herë folënë e arzave... — pa — mblidhë supet dhe vazhdonte me vete të tij:

— Kush' e di... Zoti na shpëtoftë. — Në mbrëmje lëshonte tarabatë, grillat, dhe zbriste në bimsë dhe u fliste fëmijve për kohërat e shkuara... se si njerëzit rronin të qetë, punonin si të dënin, e sekush përballonte hallin si pas fuqisë.

— Eh, njëherë njerëzit kanë qënë pa djallëzi, me perëndinë, tanë u bë ndryshe bota, shqyr i qoftë zotit. — thoshte zonja, afër mangallit. Asaj nuk i kishte qarë syri për hiçgjë në jetë.

Lufta fillonte natën, rrugë më rrugë, shtëpi më shtëpi. Gjermanët godisnin me top e mortajë andej nga xhenjua dhe spitali.

Kishte ardhur fundi i luftës së Tiranës. Gjermanët ruanin qëndrën e qytetit. Fortinat te bulevardi dhe te xhamia akoma mbaheshin dhe vështirësonin lëvizjet e partizanëve, të cilët u kishin rënë kaqherë, po s'u kishin marrë anën. Më në fund ajo e bulevardit i lau duart; te xhamia ishte një çikë si ters.

Një skuadër e partizanëve hyri në pazarin e vjetër dhe zuri vend në krah të dyqanit «Xingoni».

Gjermanët nga fortina e xhamisë vazhdonin të qëllonin.

— E, e, mos ki merak se dhe ty t'erdhi ngordhja — thoshin partizanët.

Skuadërkomandanti i porositi të mos lëvizni e të mos pinin duhan, që të mos diktoheshin.

Vetëm Birçia s'rrinte i qetë. Një çikë e një çikë e fët kokën.

Shpesh skuadërkomandanti i kishte folur po ai ishte kokëshpellë, dhe njëherë ja pruri mu në majë të hundës.

— Të urdhëroj të mos të nxjerrësh më kokën...
Birçia u bë prush në fytyrë.

— Nuk më durohet, shoku komandant. I do kërcyer kësaj.

— E, po sa t'ja gjejmë anën — tha një tjetër partizan i skuadrës:

— Do plakemi gjer ahore. Shokët po na shkojnë. I do kërcyer se na ka rënë shumë në qafë.

Në mëngët e palltos Birçia i kishte nja dy a tri vrima, po gjer ahore kishte shpëtuar paq.

Birçen e njihnin të gjithë partizanët, që spiste fare po hidhej kudo sikur të kishte dy kokë. Tregonin plot ngjarje për të. Një herë kur pat qënnë në çetë, andej nga Hormova, kish zënë një milic italiane dy kafshë shale. Në Poliçan, kur e panë për së largu, e muarën për italiane. Sa u qas, iu veshën si bletët dhe e pyesnin si i kish ngjarë kjo punë. Birçja u tregoi se qysh e kishte zënë robbieshtarin italiane, që rrinte përparrë tij si pûlë e lagët, me duar lart.

— Rendere, qën bir qëni! Se kullot barin tonë si në mall të tyt èti — i thashë.

— Si, kompanjo, komisario, — m'u përgjegj ky-

milic — e shikoni tani qysh i ka ngritur duart sa një cfurk lart.

Atje në pozicjon, partizanët i thoshin Birçes:

— Na thuaj edhe një herë si ja bëre atij italianit...

— Mor, me ata i qëruam hesapet... Tani kemi këta — dhe hop ja bënte kokës e e nxirrte ngandonjëherë. Atij s'i durohej fare.

E kishte këtë ves të keq Birçia që dreqi s'ja hiqte. Edhe vetë e dintë.

— Po ç'të bëj?... Ja, kështu, e kam këtë të metë.

Po kur bëhej kritikë dhe autokritikë gjithnjë e pranonte.

Te dyqani i «Xingonit» partizanët i kishin zënë pozicionet mirë.

Gjermanët i kishin diktuar, po nuk ua mban te t'i sulmonin se sa herë delte ndonjë nga fortina, nuk kthehej prapë.

Një ndajnatëhere, vendosën t'i bien fortinës dhe të shikonin se si e kishte punën. Nisi lufta. Një tank në bulevard vente dhe vinte me shpejtësi duke qëlluar më të dy anët.

Skuadra te dyqani i Xingonit doli nga pozicioni dhe me bomba dore u hodh përmbi fortinën. E goditën një herë dhe u kthyen e zunë përsëri pozicionet e para. Njërin e kishte marrë shkazas një plumb në pulpë. Birçia palltos i shtoi edhe dy tri vrima të tjera.

Skuadërkomandanti kur e pa Birçen, që shikonte vrimat e palltos, i tha:

— Mor, ti do të na e marrësh të keqen, me atë kokë që ke... të thashë, pse nuk more anës...

— More, unë do t'ja ha kokën asaj... që qeni qepën të hajë.

— Të kishim top, — tha një nga partizanët...
— Të kishim një tanks thuaj më mirë, po ku ta gjejmë?

— Tek gjetëm pushkët, — ja priti Birçia. — Në luftë, ore!

— E kush di ta ngasë tankun, mor i uruar. Ku të vete mëndja dhe ty!

— Oh! Sa për atë mos u bën merak... Ta kemi, pa e ngasim. Ja, si automobili — tha një qimekuq, që e quanin «shoferi», se paskësh qënë ndihmësshofer. — Unë kam qënë ndihmësshofer. Di një çikë nga zanati. Megjithqë ustai nuk më linte, unë ia shkela fshehurazi. Pastaj — vazhdoi — ju vini pas tankut, sa për të zënë pozicion dhe i këputi ca granata, që t'i fluturojë kapaku i kokës si leckë. Qejf që do të jetë... S'ka parë Shqipe., , — dhe vuri mbi sy atë kasqetë të vjetër që nuk i kishte mbetur asnjë gisht strehë.

Gëzoheshin; zëmra u bëhej mal e u ndizej flakë dhe mendonin se si do të dilnin me tank në-për Tiranë... .

— Do të bëjmë edhe ndonjë fotografi në tanks; ehu, kemi kohë që s'kemi dalë në fotografi.

Birçia e ndezi cingarin dhe e lëshoi tymin si oxhak.

— Prapë? — iu akërua skuadërkomandanti.

— M'u çà hunda, mor shok, — dhe e shoi në shuallin e opingës.

Të gjithëve u vinte maras puna e fortinos dhe ranë në mendim e fjalët i pushuan.

Më në fund Birçia e prishi qetësinë.

— Me benzинë... ta djegim me benzинë.. , sho-

ku komandant. Partizanët ngriten kryet dhi, të menduar, mblodhën vetullat.

— Mirë thua, — ja priti skuadërkomandanti. — Ta djegim me benzinë. — Pas kësaj Birçia nxori me nxitim kutinë dhe zuri të dridhte.

— Fillove? — dhe skuadërkomandanti ja rrëmbeu cingarin ashtu gjysëm të padredhur.

— Më fal. — E futi në xhep.

— Tani duhet gjetur benzinë. Në shtab — tha skuadërkomandanti.

— Vete unë gjekundi këtu afër, — dhe Birçia u ngrit në këmbë.

— Mirë. Veç gje benzinë.

Si gjarpër u shkau gjermanëve, që qëllonin nga fortina dhe në rrugën e postës u fut në një rrugicë atje afër banjave.

Natë... errët fare. Udhëve, xhangxhing... Ku të trokiste? — S'ka dhe ndonjë shtëpi të vogël, — mendoi me vete — këtejçoç janë të gjitha të mëdha... Po këto arma duhet të kenë edhe benzinë... s'është e mundur... — Duke menduar ku të trokiste, dëgjoi zëra në bimsë të një shtëpie trikatëshe, më krah të mëngjér.

Shtyu portën dhe i ra derës.

Një grua afër të pesëdhjetave, që mbante në duar një gjyveç me mish të pjekur, e po e konte nga kuzina në bimsë, ku të zotërt e shtëpisë ishin vendosur për t'u mbrojtur, e çeli derën për gjysmë.

— Nëno, desha një fjasko të madhe me benzinë; mos kini?

— Rri një herë këtu, — i tha plaka.

— S'kam kohë, nëno; më qafsh, pak shpejt...

Plaka e futi Birçen në koridor dhe zbriti në bimsë.

Nga koridori dëgjoheshin mirë fjalët që thoste i zoti i shtëpisë.

— Pushoni, ju lutem, nuk e shikoni, që kemi jetën në rrezik?

— Dreq o punë! Këtu bëhet luftë, këta brenda, si në kuvli, thonë se e kanë kokën në rrezik.

Në koridor, shtruar me qilim, një dollap i bukur me një kanat pasqyre shkëlqente nga drita e elektrikut. — Kush e di çdo të kenë!... Bën hesap ç'kanë këtu në koridor!... Nga gjithë ato bukurit, duke pirë i qetë një cingare, mblodhi buzët, i çuditur.

Me të hyrë plaka në bimsë, i zoti i shtëpisë, një burrë rondokop, i hapi sytë si të dacit dhe, me pështymë të tharë në gojë, i tha:

— E ?

— Një partizan.

— Një partizan?... Bobo... na mori lumi... ju thashë të mos bëni shumë fjalë. — Nga dora i ra luga, në tasin e supës. — E ç'do?..., Thuaju të shikojnë punën e tyre... dhe ta lënë popullin në të keqen që e ka zënë.

— S'ka ndonjë punë të rëndësishme, — i tha plaka — kaq benzinë do — dhe i tregoi grushtin e dorës.

Birçia e dëgjoi plakën që tha për benzinë, e dëgjoi edhe të zotin e shtëpisë që iu kërcënuat plakës:

— E ku t'ja gjejmë benzinën... mos jemi Agipi. Thuaji, që jemi njerëz të urtë ne. Ku ta gjejmë benzinën... Na sill bukë të hamë, dhe hiqederën.

Birçia, që nuk e hidhte cingarin gjer sa i di-

gjeshin gishtérinjtë, e flaku në shesh më zëmërim.

Plaka e mbylli derën me forcë. Edhe asaj i erdhi inat. Duke ngjitur shkallët murmuriste me vete: — Ju hangërt dreqi! — Sa doli në koridor iu qas Birçes e i ra në sup.

— Ja se ka me të gjetë nana... pa këta kështu janë mësue, çuno; kam njizet vjet në kët shtëpi dhe i njof mirë bile. Kështu kanë qënë gjithmonë, për vete të tyne vetëm... Perëndia ju marrtë hakun, çuno, juve, pa këta i duen të mirat me duer të hueja...

— Do ta marrim hakën me duart tonë, nëno...

— Edhe unë djalin e kam partizan... Ka kohë... Kush e di si asht, zemër e nanës.

— Mirë është, nëno, mirë...

— E njef tina?

— Partizan është... qysh nuk' e njoh.

Si dolli jashtë, në oborr, shkuant të dy bashkë në një haur, në krahun e djathtë të portës. Tërroqi nga një sëndyq një teneqe, mori një damzanë të vogël dhe ja mbushi buzë për buzë.

E përcolli gjer te porta e madhe.

— O zot, ruaji djemt tonë! — dhe hoqi shaminë e kokës e u shkoi dorën flokëve të saj të bardhë, të bardhë si flokët e dëborës.

Birçia duke dalë, mbështolli me nxitim edhe një tërësirë të gjatë, ku ndërnin këmishët dhe i tha plakës:

— Po e marr edhe këtë.

Prapë si gjarpër u shpëtoi plumbave të fortinës dhe me një frymë arriti te shokët.

Kur erdhi Birçia në skuadër takoi edhe zv. komisarin e kompanisë, që atë çast po ikënte dhe

e dëgjoi kur i tha skuadërkomandantit: «Nesër në mëngjes merre Birçen pér mbledhjen.»

Ishte akoma natë. Lufta dëgjohej nga të gjitha anët e Tiranës, më shumë në rrugën e Kavajës e nga ana e hotel «Bristolit».

— U erdhi ngordhja dhe këtyre fortinave, shoku komandant.

— U erdhi, Birçe, dhe s'do të na shpëtojnë, më të gjithë ata që janë brënda.

— Ne t'i lëmë të gjallë? Këmba këmbës...

Në këtë e sipër edhe ata këndezë, që kishin mbetur, zunë të këndoijnë. Tej nga maja e Dajtit zuri të zbardhëllonte dhe lufta u rrallua.

Dita u hap.

Birçia duke ruajtur atë damizanë si djalën e vetëm, po shikonte në sy skuadërkomandantin dhe priste t'i thoshte që të ikën tok. Atë mëngjes faqet i ndizeshin zjarr.

Skuadërkomandanti, pasi porositi partizanët që të kishin mëndjen, tok me Birçen, hyri brënda pazarit të vjetër, pér në shtabin e bataljonit.

Koha ishte e vrënjtur dhe e ngrohët.

... Në pasdrekë skuadërkomandanti dhe Birçia, si u kthyen përsëri, u mbështetën pak të çlodheshin, po i zuri gjumi.

Birçes i kishte rënë një hie e bukur. Me fiaskon në të dy duart, shikonte në ëndër të zotin e shtëpisë që i bërtiste plakës se s'qe litari i këmi-shëve në oborr.

— Ti je e humbur... Unë të mbaj me të gjitha të mirat; ti je bukëshkalë. — Pastaj, duke ulur zërin, e merrete me të mire: unë e di që nesër ty ç'të mban... Kush e di ç'do të të bëhet djali. — Dhe Birçes i u bë në gjumë se si plakës iu këthye

i biri e ai burri barkosh e përqafoi dhe e puthi gjasme si djalin e tij dhe i tha: — shyqyr që shpëtuat, sa herë ju kemi kujtar... ja, pyet edhe mëmën.

Po atë çast u zgjua.

— Tiranën do ta çlirojmë!... Është direktyva e Partisë sonë — dhe u ngrit më këmbë! Asnjëherë tjetër s'kishte qënë aq i fortë Birçia sa atë mbrëma. Atë ditë qe bërë anëtar partie.

Të gjitha rrugët qenë zbrazur. Dritat kryesore qenë ndezür.

Partizanët panë automatikët, i mbushën gjer në grykë, i vunë bombat në xhep dhe mendonin se atë natë me fortinon duhej t'i ndanin lakerat.

Skuadërkomandanti u tregoi partizanëve si të qëllonin, si të kishin kujdes kur të sulmonin dhe të mos bënin marrëzira.

Lufta u ndez në çdo anë, edhe nga fortinua afër xhamisë përballë «Xingonit»... Birçia, si leu litarin me benzинë, e mbylli përsëri mirë e mirë damizanën.

— Hë, tani i erdhi ngordhja. Pse, vetëm ata dinë? — Po u fliste shokëve «shoferi», ai partizani qimekuq.

Çdo gjë ishte në rregull. Birçia hypi mbi dy-qan nga prapa dhe, duke u zvarisur, u qas në cepin kundrejt fortinos e, me sa fuqi që kish, e vërtiti damizanën e lidhur me litar mu afër saj.

Cepin e litarit e mbante fort.

Mitralozi ja nisi.

— Tani?... Tani e sheh, sa të vëlen lëkura. Dhe pa humbur kohë i vuri shkrepsen litarit, që u ndez sa kaq e flaka vajti gjer atje ku qe thyer damizana.

- Fortinua në flakë! — britën partizanët.
- Përpara! — urdhëroi skuadërkomandanti.
- Përpara! — tha Birçia dhe u vërsul si astrit.
E tërë skuadra filloi pushkën e me bomba do-re u fuq brënda në fortino...

Të nesërmen në mëngjes, në Tiranë, s'u dë-gjua më zëri i fortinove dhe i tankeve... po zëri
dhe kënga e partizanëve, që prisnin Komandantin fitimtar.

Birçia e priti Komandantin atje te fortinua.



NË DITËT E PUNËS

Inxhinier Agim Cerja, në barakën e vogël afër kantierit, si palosi një dosje me shkresat, zuri të merrej me llogaritje mbi një letër të madhe vizatimi. Duke shikuar herë projektin, herë gjithë ato llogaritje, zëmra i rrihte me shpejtësi: ato vija e ato shifra një ditë do të shndroheshin në një pallat madhështor katërkatësh. Endëra e rinisë

së parë, që të bëhej arqitekt, tani i qe bërë përpara syve të tij një gjë e vërtetë. Po; duke vështruar atë projekt, e ato llogaritje, atë e ngacmorate më shumë një ngjarje e kaluar e kohës së luftës nacional-çlirimitare, që i gërshtohej në gjëzimin e tij të madh. Atij i kujtohej lufta, që ishte zhviluar n'atë qoshe rruge në nëndor të vitit 1944. Ishte i vogël asokohë dhe kujtimet e vegjëlisë mbeten përhëre të gjalla. Prandaj, midis atyre vijave dhe shfrave, po humbiste në mendime dhe duke hedhur vështrimin në një vend, mundohej të mos harronte as gjënë më të vogël:

* * *

... Komandanti e komisari, sa u dhanë partizanëve udhëzimet për sulm, u larguan, se vija e frontit qe shumë e hapur e, po të vonoheshin, nuk do të mbërrinin më kohë në pozicionet e të gjitha skuadrave.

Atë natë duhej prere bulevardi në mes.

Partizanët, të paduruar, prisin urdhërin tash Sulmonin. Duke pritur, saherë që dëgjonin ndonjë mitroloz gjerman, fillonin ta merrnin në të hollë:

— Kollitu, kollitu, edhe ca

— E po, e ka zënë ftoma, — u tall «Vjosa», një partizan korrozi, me një palë mustaqe të varurë si të pleqve.

«Vjosa» kishte datë partizan, në çeten «Koti Hoxhi» tre muaj përpëra se të kapitullonte Italia. Për herë të parë në luftë ra ne Borsh, përmbi Iz-ruar, e pastaj në Papadhi dhe i pa se si u katan- disëns ushtarët e divizioniit «Perugia».

Përpëra luftës, hyzmeqar në një han të Pë-

metit, kishte kaluar gjithë vegjeline e tij me hidhërim e skamje të madhe.

Kur mërzitej shkonte nga Mejdani, e përndënë burim, i binte më not Vjosës tejpërtej. Gjersa doli partizan s'dinte tjetër botë vetëm Përmetin dhe Vjosën, që është e bukur dhe e rrëmbyer. Ai i donte vendet e Vjosës së tërbuar, që në dimër e hedh valën përpjetë si mal.

— Kështu jam edhe unë; pse, kote katër këtë pseudonim, «Vjosë?». «Vjosë», pasi ku ka përmbi Vjosën! — u lëvdohej shokëve kur nxehej.

Partizanët ishin bërë si të shtëpisë n'atë lagje. Po më shumë qenë bërë miq me Agimin e vogël, që atje te pozicioni hiqej tamam si partizan. Nga ndonjëherë me Vjosëri ai bënte shëtitjen një shesh të vogël me selvia. Më nj'anë të xhaketës kishte qepur një yll të kuq me rruaza, përtë cilën e ngisnin se gjasme tanigje paskësh vënë yllin. Ai rrëmbehej:

— Ku di gja ti. Unë edhe kur ishin ballistët e mbaja. Komunikatat kush t'i jepte ty? Pse, nuk të kam dhanë unë «Zerin e Popullit»? Q'na flet dhe ti!... Kështu e kanë çunat, — i kthehej «Vjosë» duke i hedhur dorën në gjerdah.

— Mbrëmje! Çastët përsulm po afëronin Agimi i vogël po priste edhe ai.

— Sonte kam me ardhë edhe unë me ju, «Vjosë». — Ku? —

— Kuntë shkoni ju. —

— Po ne s'do të vemi gjekundi.

— Eh! Lenji ato. Pse te i pastrove pushkën sot

ti?

— Po ti s'kë armë.

— Pse po wij me ju? që ta ngjesh edhe unë, nji patllake... e di sa ikam qejf?

— Ishte i ri fort, po si bojli dëftonte më i rritur.

Nata zuri të bjerë. Gjermanët hidhnin fyshek-zarë. Komisari, sa u kthyte, nxori nga çanta një letër dhe, si shënoi diçka, hoci automatikun nga supi.

Mitrolozi ja nisi nga taraca e maternitetit. Partizanët akoma s'kishini filluar. Dëgjohej luftë vetëm andej nga Instituti i vajzave, nga xhamia e vjetër e në hotel «Bristol». Nga bulevardi s'kish te nisur akoma përfundon gjithë luftët e shtetit.

Në atë kohë shumë vajza e gra grahën në rrugicat e ngushta. Kush i binte ndonjë tavolinë të vjetër, kushi ndonjë karekëll. Një grua po sillte në krahë një derë, të vjetër llamarine; një vajzë e rre, një hekur nga të dekoyilave.

— Për barikadë?

— Posill! — und eilla tash më së puto. — Shiu «Vjosë» e shikonte Agimin, këtë vogëlush që silindrahej edhe kënaqej më të që kishte kaqë zemër.

— Nisemile! — Urdhëroi komisari. Partizanët, të hëشتur, ecën njëri i pas jetrit.

Agimi i vogël, e lërhqiqi «Vjosën» nga çanta.

— Po parullën? — shihua ent marr etet?

— Po këtë ç'e ke? — e pyeti komisari «Vjosën».

— E, edhe unë — ja priti Agimi. Pastaj duke futur dorën në xhep nxori dëfizitëgojnë bombë italiane. — Pa shih, sijam i ashtu pa! — — Joa në Mosh se viks dista si edhe shënuar! —

— Do ta shikojmë.

Skuadra me që s'ishte shumë larg pozitionit të

luftës arriti shpejt të cepi, për nën murin e oborrit, nga ana e mëngjert e maternitetit, në rrugën që të çon në Boulevard nga fusha e druve.

Një autoblindë poshtë e lart bulevardit gjuejante ku të mundëte. Gjermanët në shtëpinë përkarshi, në krah të shtypshkronjës ishin armatosur gjer në dhëmbë.

Tirana tundëj nga luftë. Mitralozi s'pushonte. Vetëm nga kjo anë akoma s'po niste përpjekja.

Komisari po priste i qetë, duke mbajtur vesh kur komandanti do të godiste nga ana e sipërme e maternitetit. Atje, pas tyre, Agimi të vogël i hidhej zëmra dhei që mbledhur sa një arrë. Ora e madhe rana nëntë dhenë këndej u dëgjuan fjalët e zakonëshme partizane: — Përpara! — Bomba e dorës e automatiku zutë rrëhë fortinon. Vendu ndez flakë.

Skuadra me komisarin në ballë, pas tyre, dhe Agimi i vogël, që s'po u shqitej, u sulën nëpër bulevardi si shigjetat. Lufta filloj edhe këtu. «Vjosa», sa zuri vend, në qoshe të rrugës, shtinte me mitraloz për t'i prerë rrugën autoblindës, sa një shkemb midis bulevardit, e cila po qëllonte pa pushim. Dy partizanë dhe komisari, meta edhe Agimi i vogël, duke kaluar matanë rrugës, i detyruan tre gjermanë të futen në një shtëpi të verdhë dykatëshe. Duke u përlleshur brënda shkallës, më shkallë, i shtrinë përdhe. Te dera e ballkonit ngritën një mitraloz dhe tanë, po mbrojnë më mirë të dy rrugët. Që lart maternitetit një mitraljer gjerman ra poshtë, në kokët, të shpinës. Komandanti me skuadrën tjeter ja mbyllt gojen fortinos. Ushtima e predhave të autoblindës

po mekej. Predhat e pushkëve dhe mitralozave të partizanëve, nga fortinua, nga lart maternitetit, nga ballkonit i asaj shtëpie të verdhë, atje në skaj, tani po rrithnin gjithë bulevardin drejt qendrës së qytetit. Në mëngjes heret tejpërtej bulevardit u ngrit një barikadë.

Kur erdhën shokët për të marrë «Vjosën» të vrasë, Agimi mbeti një copë herë me sy të gozduar, në gjakun e derdhur, mbi trotuar.

Me ngasherim dhe buzë të dredhur, me grusht përpjetë thirri edhe ai me shokët bashkë.

— Do ët'jas marrim chakën!

Agimi me pushkën e bëtij të gjatë në supë me një kartë me mollë po shkonte në spital. Shokët partizanë, që njoihu asaj javë, ishin larguar nër vise të tjera. Për vete punonte në komandën e lagjes dhe atë ditë kishte marrë lejë.

Në spital, sai hyri, kërkoi pavjonin ku ishtë shtruar togkomandanti, ai partizani me flokët kacurrela e me një nishan të kuq afër syrit të djathë, që u plagos atë nate në fortino, në fund të bulevardit. Sa e gjeti e përdoroi e e puthi.

— Ata shokët ikën, shoku komandanti. Sa të shërohesh po vi me ty.

Togkomandanti, që kish zënë të përmirësohej, e ledhatoi me dashuri, këtë çunak, që vetëm një herë e kishte takuar, po që e mbante mënd mirë, se asnjë s'kishte qarë aq fort për «Vjosën» sa ky.

Pastaj nga nen jasteku nxori një numur të gazetës «Buletini i luftës Nacional-Clirimtare, dhe lexoi çfarë shkruanin për luftën e asaj nate.

Agimit tē vogël ja mbushi zëmrën një ndjënjë gëzimi. Por me tē dëgjuar emrin e partizanit «Vjosa», u pikëllua dhe hogi në zëmër:

— I shkreti — dotët i modhën nëpër faqet e tij tē mbushura.

Togkomandanti ezzuri nga dora.

— Ti je i ri. Do te rrithesh i lumtur. Ke tē drejtë tē helmohesh pér «Vjosën». Merre këtë gazetë dhe atje në bankat e shkollës e në punë kur tē rrithesh mos e harro «Vjosën».

Pak metra më tutje, ku u vta «Vjosa», inxhinjeri Agim Çeraj ai Agimi i vogël, i njëhershëm, duke kujtar gjithë keto që kishin ngjarë atë natë nëndori, shikonte se si shpejt e shpejt muratorët, karpentierët, suvatoret po ngrinin një pallat tē ri.

MEDIALI E TRIMERRIT

Kur Tefeqi sa qëndorte nënët e tjetrit ishte i besi që shpërblonte me ulësiste Gjergjën. Që ka qëndruar i trespërditë e mëparshu bës tifur. Dhe që vërtet është i hënësuar. Njëherë kishte varet ulje ulje përgjegjësi i tjetrit që ishte kryqatë që kurante që kishte përgjegjësim e që jutte rreth që bëri të gjithë i kishtë varet që tjetri që edhe këndë. Pas kësaj uljejzari e kishtë përgjegjësim e tjetrit. Po as qëndonte me shumë ishte këndi qëndrues. Me të s'i pëpël gjëskunë që po të shkodrojti përgjegjësi-pasjet e postkomunikezës së poshtmeve qëndruese.



MEDALJA E TRIMËRISË

Xha Telua, sa dëgjonte luftë afër fshatit, ishte i pari që shkonte me njësitë guerrile. Që në të ri fshatarët e mbanin për trim. Dhe qe vërtet i dëgjuar. Njëherë kishte vrarë një ujk; një herë tjetër kishte kthyer ca kusarë dhe kishte bërë gjysmë orë luftë me 'ta për të cilin i kishin ngritur edhe këngë. Pas kësaj ngjarje e kishin bërë rojtës të fshatit.

Po ata që kishte më shumë inat ishin dhjetarët. Me ta s'i hahej gjökundi dhe, po të shikojet procesverbalet e postkomandës së komunes, emëri

Txha Telos që bëre historig. Edhe aqë e që mbetur në Vjosën një dhjetar nga Gjirökastrat, xha Telua kishte thënë së bëjët i tashës. I dëgjohet, polqendohet, atë i mbyti i lumi, ta kishim vrarë ne vëtë se pëtësiftejtëm, na e kishte bërë borxhi.

Në kohën e luftës nacional-çlirimtare xha Telua ishte plak. Po më gjith qleqerinë e tij, edhe pse i zihej fryma, ai s'ja përtontë me një patikë të gjatë kishte bërë ca trimëfirat qëtësifshati, si vëtë, i mbanin një gojëtë mëdha e nelloje.

Në darkë, më burrat te sheshi përparrë kishës ndënë dy çerçenë të lartë e plot mës xha Telua gjithnjë punë trimëri hapte. Dhe bënte si bënte e sillte fjalën te luftai e Kserolakut, ku pârte ardhur ca gjermanë dhe ballistë, atëherë që bëri luftë batalioni dytë i brigadës gjashëtë e vogël, sa

— Kam bëre edhe te tjera luftëra u thoshtë xha Telua, po jo si kjo. — Pastaj histë te kallëzonte, se qysh erdhën gjermanët, se qysh i priten e qysh i futën në Kserolak e's dolën më.

— Desh na hengë. Une u thoshja shokeve ejani te vemi këtej nga Lopatat. Ata hic... Dreq o punë!... Mor, ejani këndej, dëgjomeni mua... se jam i vjetër në këto punëra... Na... hyh gozh! dë në mur?... Hiqu lanet, thashë... Neise, më në fund u rashi gjermanëve te ballistëve, sa që u bë tym vendi... U vervita vëtë sipërs tyre dherë i ngordha një katër. Të kishim dëgjuar Rakoff? Në mori djallin... Po një herë, kuri po mburëj, Rafa, sekretari i këshillit, ja kishte prerë. E, o Telo, se dhe te tjerët smetës përapar!

Kjo fjalë i kishte qëndruar rëndë, dhe tanj kishte kohë që s'para fliste.

Rifua, qëkur i kishin djegur shtëpinë ballistët, rrinte në një konak qafëntxha. Telos: Fshati e donte shumë, dhe pas luftës e kishin zgjedhur sekretar të Këshillit. Po dhe Rifua qiri më këmbë i digjej fshatit. Kish shkuar ndo një vit e gjysëm nga koha e luftës, dhe fshati kishte filluar të ndreqeje e të merrte veten. Ca shtëpi të djegura i kishin ndërtuar, shkollën e kishin mëremetuar. Kishin rrëgulluar ujet e fushës dhe kishin mbaruar grindjet që ngjishnin më parë për punën e vaditjes dhe tanic nuk lthehet më pjeri nga fusha me kokë tē lidhur e gjakëra, në fytyrë. Djelmuria, te muri shkollës, darkë për darkë ja thoshin këngës së Jorgo Durit, që u vras në luftë dhe të Seyo Lefterit, që u përpoo si ai, po që vdiq në pëvsmë të punës. Fshati oshëtirite nga të vegjelit. Gratë ndregjin, vijen e ndanin ujet në kopshtra. Burrat nga mali, dhe nga fusha vinin të gëzuar dhe pas punës mblidheshin andej nga këshilli. Xha Telua i pari.

Po që kur u bënë zgjedhjet e reja, me që atë nuk e zgjodhën më se ishte i vetëm e plak, kishte varur buzëti. E, po, e na duan neye, një herë kur kërciti në Kserolak, na donin. Dhës kështu që hapur fjalë, se xha Telua s'po fliste mirë. Thoshin se edhe Rifua, që pas asaj fjalës, që i kishte thënë, si përtaturojuar, i kishte dalë nga zëmra. Nga ky shkak kishte kohë që s'dilte as nga sheshi i kishës, as nga këshilli. Edhe

në konferenca sa herë që vente dha hapeshin diskutimet, pyeste:

— Me leje, dua të pyes, pse, xhanëm, duhet njeriu të dijë të shkruajë që të jetë në këshillë? — se edhe kjo e kishte prekur pasi një bashkëfshatar i pat thënë se nuk e kishin propozuar me që s'dinte të shkruante,

Po dhe xha Telua edhe donte edhe s'donte të mësonte, veçse nuk e linte inati. Edhe kur ishte folur për kursin kundër analfabetizmit, ai kishte thënë:

— C'janë këto?.. Të gjithë gramatiko do të bëhem? Se mos dija unë të shkruaja që bëra luftë në Kserolak!... — pastaj, i kishte përgeshtur: — Shyqyr që dinë të tjerët! — Në darkë kur kishte shkuar në shtëpi e kishte ndier veten të lehtesar si nga një gjë që e brente në zëmër.

Rifua, duke ja ditur zakonin, s'ja vinte veshin për këto që thoshte.

... Një ditë e thirën në shkollë se kishte ardhur një shok nga Komiteti Ekzekutiv Gjirokastrës. I qe bërë qejfi shumë. Mbushi kufinë me duhan. Vuri pastaj medaljen e Kujtimit, dhe pasi e fshiu nga dy herë me dorë e pyeti plakën:

Plakë, pa shiko, e kam vënë mirë?

Ajo, duke iu qasur afer, iu përgjegji:

— Ro mirë, më duket more burri.

C'mirë, të rëntë pika, ku e pe; ikë një cikë më tutje dhe shikoje nga larg! — Pastaj, si mori bastunin e thantë duke nxituar u nis për në shkollë, se atje, i thanë ishte ai, që kishte ardhur nga Gjirokastra.

Një djalosh, që rrinte te dera e ndaloj.

— Prit pak xha Telo, sé kanë punë.

— siu li Të pres? Vëtë më kanë thirrur.

— E po një çikë me rregull; mbasë flasën përfindonjë çështje të fshëhtë, që s'duhet ta dëgjosh.

— Puna nuk dëgjohet! Edhe nga unë kanë gjëra të fshëhta? Mirë, mirë, bër, ty ashtu të kanë thënë, shke faj ti... E di unë kush m'i bën këtë... Po do të shohë se ç'do t'i punoj edhe unë... të mos panë dhë se vetëm ai bëshë? Pastaj u ul në prak të derës. Nxori kutinë e bëri një duhan dhe shikonte tej nga Kserolaku.

